SHKENCA PËR GJENOCID e MIT

Manual | Dhjetor 2024

Përgatitur nga

Koalicioni për Palestinën i MIT

eyesonmit@gmail.com

mit_caa

Mirënjohje

Koalicioni ynë

Koalicioni për Palestinën i MIT përbëhet nga organizatat në vijim:

MIT Alumni for Palestine (A4P) – (Alumni për Palestinën i MIT)

MIT Arab Student Organization (ASO) – (Organizata e Studentëve Arabë të MIT)

MIT Asian American Initiative (AAI) – (Nisma Aziatike-Amerikane e MIT)

MIT Black Graduate Student Association (BGSA) – (Asociacioni i Studentëve të Zinj të Diplomuar të MIT)

MIT Black Students' Union (BSU) – (Unioni i Studentëve të Zinj të MIT)

MIT Disability Justice Collective (DJC) – (Kolektivi i Drejtësisë për Aftësinë e Kufizuar i MIT)

MIT Coalition Against Apartheid (CAA) (Koalicioni Kundër Aparteidit i MIT)

MIT Divest

MIT DUSP for Palestinian Liberation (D4PL) (Departamenti i Studimeve Urbane dhe Planifikimit i MIT për Çlirimin e Palestinës)

MIT Faculty and Staff for Palestine (FS4P) – (Fakulteti dhe Stafi për Palestinën i MIT)

MIT Globally Indigenous Students for Justice (IS4J) – (Studentë Globalisht Indigjenë për Drejtësi te MIT)

MIT Grads for Palestine (G4P) – (Të Diplomuarit e MIT për Palestinën)

MIT Jews for Collective Liberation (JCL) – (Çifutët për Çlirim Kolektiv të MIT)

MIT Latino Cultural Center (LCC) – (Qendra Kulturore Latino e MIT)

MIT Muslims for Justice (M4J) – (Muslimanët e MIT për Drejtësi)

MIT Reading for Revolution (R4R) – (Leximi për Revolucion i MIT)

MIT Taara

Palestine@MIT (Pal@MIT)

MIT Written Revolution – (Revolucioni i Shkruar i MIT)

Trans@MIT

Autorët

Ky raport ka për autorë studentët dhe shkencëtarët e shqetësuar në Institutin për Teknologji të Massachusetts-it.

Leje

Leja jepet për riprodhim jo-komercial, kopjim, shpërndarje dhe transmetim të këtij publikimi ose pjesëve të tij për sa kohë që të gjitha meritat i njihen Koalicionit për Palestinën të MIT.

Falënderimi ynë

Autorët i falënderojnë shumë individë që dhanë komentet e tyre për draftet e mëhershme të këtij raporti. Ata i falënderojnë gjithashtu autorët dhe aktivistët që kanë prodhuar hulumtimin mbi të cilin mbështetet ky punim.

Rreth Koalicionit për Palestinën të MIT

MIT Coalition for Palestine (Koalicioni për Palestinën i Institutit për Teknologji të Masatchusetts-**it) është një lëvizje shkencëtarësh të MIT që i kundërvihen kolonializmit, pushtimit dhe aparteidit në Palestinë dhe jo vetëm. Ne udhëhiqemi nga katër parime të unitetit: 1) Ne jemi të zotuar për çlirimin e Palestinës. 2) Ne mbështesim të drejtën e popullit të shtypur dhe të pushtuar për t'i bërë qëndresë shtypjes së tyre. 3) Ne luftojmë për çlirimin e Palestinës brenda luftës më të gjerë për çlirimin e të gjithë popujve të shtypur. 4) Ne mbrojmë të drejtën e çdo njeriu për të jetuar një jetë me dinjitet.**

Për fëmijët e Palestinës

Tri vajza të vogla në Gaza rreth viteve 1940 © Kegham Djeghalian

Faris Udeh, 14-vjeçari i martirizuar (2000)

O fëmijë maskarenj të Gazës

Ju që vazhdimisht më shqetësonit me britmat tuaja nën dritaren time,
Ju që e mbushnit çdo mëngjes me nxitim dhe kaos,
Ju që më thyet vazon dhe ma vodhët lulen e vetmuar në ballkonin tim,
Kthehuni –
Dhe bërtitni sa të doni,
Dhe thyejini të gjitha vazot,
Vidhni të gjitha lulet,
Kthehuni,
Vetëm kthehuni…

– Halid Xhuma, 2014

Hind Rexheb, 5-vjeçarja e martirizuar (2024)

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive 7

Pjesa 1: Krimet në vazhdim në Palestinë 10

- 1.1 Gjenocidi i Gazës
- 1.2 Nakba dhe kolonializmi i kolonëve
- 1.3 Ekonomia politike e një gjenocidi

Pjesa 2: Shkenca për Gjenocid e MIT 32

- 2.1 Si vepron Sponsorizimi i Kërkimit i MIT
- 2.2 **Financimi** ushtarak izraelit nga Laboratori dhe PI
- 2.3 Kush përfiton?

Pjesa 3: Bashkëpunimet e MIT me kontraktuesit ushtarakë izraelitë 41

- 3.1 Elbit Systems
- 3.2 Maersk
- 3.3 Caterpillar Inc
- 3.4 Lockheed Martin

Pjesa 4: Përgjigjja e MIT dhe fushata jonë 48

- 4.1 Kërkesat që nga 2023
- 4.2 Rregullat e vetë MIT
- 4.3 Rregullat e MIT dhe Ligji Federal
- 4.4 Ukraina, Darfuri, dhe Sinkiangu
- 4.5 Jeffrey Epstein & Aramco Saudite

Pjesa 5: Veprimet e menjëhershme dhe hapat e ardhshëm 57

- 5.1 Zyrtarët e MIT
- 5.2 Trupi pedagogjik i MIT
- 5.3 Studentët e MIT

Pjesa 6: Përfundim 65

Pjesa 7: Veprat e cituara dhe referenca për burime të tjera 68



شكل رقم (١٠)
انتاج زيت الزيتون فى فلسطين

Përmbledhja ekzekutive

Aid Ebu Amru gjatë Marshimit të Madh të Kthimit, 2018 © Mustafa Hassouna

Ushtarë izraelitë në Bejt Lahia, Gaza, dhjetor, 2023 © Yonatan Sindel

Përmbledhje ekzekutive

Pjesa I

Instituti i Teknologjisë i Massachusetts-it (MIT) kontribuon në gjenocidin e Gazës dhe kolonializmin e kolonëve apo ardhacakëve sionistë në Palestinë në të paktën dy mënyra të ndryshme. Së pari, **laboratorët e MIT në kampus bëjnë kërkime mbi armët dhe mbikëqyrjen të sponsorizuara drejtpërdrejt nga ushtria izraelite**. Të paktën që nga viti 2015, laboratorët e MIT kanë marrë miliona dollarë nga Ministria izraelite e Mbrojtjes për projekte për zhvillimin e algoritmeve që ndihmojnë mizëri të dronëve për t'i ndjekur më mirë objektivat që u shpëtojnë; për të përmirësuar teknologjinë e mbikëqyrjes nënujore; dhe mbështesin avionët ushtarakë që të shmangin raketat. Dy nga këto sponsorizime u rinovuan që nga 7 tetori 2023, ndërsa një u bë për rinovim në dhjetor 2024. Së dyti, MIT mban bashkëpunime institucionale përmes programeve ILP, LGO, CSAIL dhe MIT Energy Initiative me kompani që i shesin sasi të mëdha armësh Izraelit. Këto përfshijnë: Elbit Systems, kontraktuesi më i madh ushtarak i Izraelit, si dhe Maersk, Lockheed Martin dhe Caterpillar. Këto bashkëpunime u japin atyre që përfitojnë nga gjenocidi qasje të privilegjuar në talentin dhe ekspertizën e MIT.

Lidhjet e MIT me gjenocidin e palestinezëve janë **imorale, të paligjshme dhe jopopullore** në mesin e komunitetit të MIT. Sponsorizimet thyejnë rregullat e MIT-it për angazhimet e huaja, etikën shkencore, mosdiskriminimin, shëndetin, sigurinë dhe mjedisin, si dhe ligjin federal dhe ndërkombëtar. Duke nxitur gjenocidin, MIT u dërgon një mesazh palestinezëve në MIT se nuk e vlerëson jetën e tyre njerëzore. MIT ka fuqinë për t'i dhënë fund lidhjeve të veta në mënyrë të njëanshme, ashtu siç kanë shkollat e tjera në Evropë dhe Amerikën e Veriut. Për shembull, që nga viti 2020 MIT ka ndërmarrë veprime kundër lidhjeve kërkimore dhe partneritetit korporativ mbi shqetësimet politike dhe të të drejtave të njeriut në Sinkiang, Ukrainë dhe Lindjen e Mesme. Me pjesëmarrjen më të lartë që mbahet në mend, trupi studentor ratifikoi dy referendume në të gjithë kampusin në vitin 2024 për t'i dhënë fund lidhjeve të MIT me krimet izraelite kundër njerëzimit: një votë 63.7 për qind pro në Shoqatën e Studentëve të MIT dhe një votë 70.5 për qind në Unionin e Studentëve të Diplomuar – me mbështetje të gjerë nga trupi pedagogjik dhe stafi. Kjo u pasua në dhjetor të vitit 2024 nga një rezolutë në Këshillin e Studentëve të Diplomuar për t'i dhënë fund të gjitha sponsorizimeve kërkimore nga Ministria e Mbrojtjes e Izraelit.

Përmbledhje ekzekutive

Pjesa II

Pjesa tjetër e këtij manuali kërkimor është organizuar si më poshtë. Pjesa 1.1 (Gjenocidi i Gazës) shpjegon në detaje pse lufta izraelite në Gaza që nga 7 tetori 2023 nuk është thjesht një luftë apo seri krimesh lufte, por është një fushatë e organizuar gjenocidi në qëllim dhe pasojë. Pjesa 1.2 (Nakba dhe kolonializmi i kolonëve, apo ardhacakëve) e vendos këtë projekt gjenocidi në kontekstin historik të Sionizmit, ndërsa Pjesa 1.3 (Ekonomia Politike e një Gjenocidi) shqyrton se si ato projekte mbështeten në masë të madhe në financat publike, armët, mbrojtjen e shtetit, kapitalin privat dhe filantropinë amerikane. Pjesa e fundit e këtij seksioni (Roli i universiteteve) detajon rolin e përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë në mundësimin, por edhe në të sfiduarit e këtyre krimeve.

Pjesa 2.1 më pas shqyrton se si kryhen kërkimet shkencore në MIT dhe rolin e përgjithshëm të financimit të Ministrisë së Mbrojtjes të Izraelit në MIT. Pjesa 2.2 shqyrton projektet specifike kërkimore dhe hetuesit kryesorë (PI) që mbështeten në financimin ushtarak izraelit, ndërsa Pjesa 2.3 vlerëson në mënyrë kritike se kush përfiton nga ky kërkim. Pjesa 3 dhe nënpjesët e saj shqyrtojnë më pas në detaje bashkëpunimet e MIT me prodhuesit e armëve që ndihmojnë dhe përkrahin krimet e shtetit izraelit, në veçanti: Elbit Systems, Maersk, Caterpillar Inc. dhe Lockheed Martin. Pjesa 4.1 paraqet kërkesat e Koalicionit për Palestinën të MIT që nga vjeshta e vitit 2023 dhe përgjigjen represive të Institutit. Pjesa 4.2 shpjegon politikat specifike të MIT të cilat MIT i ka thyer për ruajtjen e këtyre lidhjeve. Pjesa 4.3 paraqet precedentin e MIT për ndërprerjen e lidhjeve me abuzuesit e të drejtave të njeriut. Pjesa 5 përshkruan më pas veprimet e menjëhershme që duhet të ndërmarrin autoritetet e MIT: Presidenti, Thesarmbajtësi, Kancelari, Rektori, Korporata, zyrat më të ulëta si dhe trupi pedagogjik dhe studentët e MIT. Pjesa 6 bën përfundimin.

Gjenocidi i Gazës

Han Junis, 11 qershor, 2024. © Eyad Baba | AFP

Gjenocidi i Gazës (2023-aktualisht)

Sulm ajror izraelit në Gaza, 7 tetor, 2023 © Wafa

> *O, Vdekje, qëllimi ynë është i qartë:*
> *Ne do të të mposhtim,*
> *Edhe nëse na vrasin, që të gjithë.*
> *Vdekje, kij frikë nga ne,*
> *Se ja ku jemi, të pafrikësuar.*
>
> *Temim el-Berguti, përkthyer nga Rifat el-Arir*

Konventa e Gjenocidit dhe Statuti i Romës e përkufizojnë gjenocidin si "synim për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar". Që nga sulmi i Hamasit më 7 tetor 2023, forcat izraelite janë përpjekur të kryejnë gjenocid përmes një fushate sistematike, të qëllimshme të vrasjeve masive dhe vdekjes nga uria të palestinezëve në Gaza dhe shkatërrimit në shkallë të gjerë të shoqërisë dhe infrastrukturës së Gazës. Rripi i Gazës është një territor me popullsi të dendur, të getoizuar, 6 me 25 milje katrorë (10 x 40 km katrorë), ku dy milionë palestinezë kanë jetuar nën rrethimin e imponuar nga Izraeli për 17 vjet. Që nga viti 2007, Gaza është bërë gjithnjë e më e varfër dhe e pajetueshme për shkak të bllokadës ajrore, tokësore dhe detare të imponuar nga Izraeli dhe Egjipti, si dhe fushatat periodike të bombardimeve nga qeveria izraelite në vitet 2008, 2012, 2014, 2018 dhe 2021.

Nga tetori 2023 deri në nëntor 2024, forcat izraelite hodhën më shumë se 85.000 ton eksploziv në Rripin e Gazës, duke tejkaluar peshën e kombinuar të të gjitha bombave të hedhura në Londër, Dresden dhe Hamburg në Luftën e Dytë Botërore[1] Pasojat e kësaj janë plotësisht të parashikuara dhe të pranuara. "Asgjë nuk ndodh rastësisht", raportuan burimet e ushtrisë izraelite për mediat hebraike. "Kur një vajzë 3-vjeçare vritet në një shtëpi në Gaza, kjo ndodh për shkak se dikush në ushtri vendos se nuk është ndonjë punë e madhe që ajo të vritet – se ky ishte një çmim që ia vlente të paguhej për të goditur një [tjetër] cak".

1 Pape, Robert. "Hamas Is Winning." *Foreign Affairs.* 21 qershor, 2024.

Efektet

Prova e parë janë efektet. Të paktën 45.000 palestinezë janë vrarë drejtpërdrejt dhe 105.000 janë plagosur. 70 për qind e të vrarëve janë gra dhe fëmijë sipas Kombeve të Bashkuara. [2] Numrat e vdekjeve nga ministria lokale e shëndetësisë gjykohen si të besueshme nga revista mjekësore *The Lancet*, Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Departamenti i Shtetit i SHBA. Dhjetëra mijëra të tjerë janë varrosur nën rrënoja ose janë zhdukur me forcë në kampet e burgjeve izraelite si Sde Teiman, ku të mbijetuarit kanë raportuar tortura, uri dhe përdhunime të përhapura. Oxfam raportoi në janar 2024 se shkalla e vrasjeve në Gaza është më e larta e regjistruar nga çdo konflikt i armatosur në shekullin e 21-të – më shumë se ato në: Siri, Irak, Sudan dhe Ukrainë. Në korrik 2024, ekspertët shëndetësorë të *The Lancet* e vlerësuan vdekshmërinë shtesë në 186.000, ose 7,9% të popullsisë së Gazës. Në tetor 2024, një tjetër vlerësim i pavarur nga 99 mjekë amerikanë që punonin në Gaza vlerësoi numrin e vdekjeve tashmë te ishte më i madh se 118.908, ose 5,4% e popullsisë së Palestinës në Gaza. Këto akte të vrasjeve masive kanë emra: masakrat e tendës, miellit, kishave dhe autokolonave të ndihmës, masakrat në spitale dhe masakrat në kampet Nuseirat, El-Mevasi dhe Xhabalia. Sipas fjalëve të vetë kryeministrit izraelit në shtator 2024, "qëllimet tona janë të qarta dhe veprimet tona flasin vetë".

Raphaël Lemkin, avokati polak-çifut, i cili e prezantoi fjalën gjenocid në vitet 1940, kishte një kuptim më të thellë të gjenocidit sesa vrasjet e drejtpërdrejta, masive: "ai synon më tepër të nënkuptojë një plan të koordinuar veprimesh të ndryshme që synojnë shkatërrimin e themeleve thelbësore të jetës së grupeve kombëtare", duke përfshirë: "shpërbërjen e institucioneve politike dhe sociale, të kulturës, gjuhës, ndjenjave kombëtare, fesë dhe ekzistencës ekonomike [të tyre]". Kjo është po ashtu politika izraelite në Gaza.

Deri në prill 2024, raportuesit e OKB-së raportuan

Shkatërrimi i ndërtesave në Gaza



Burimet: OpenStreetMap; analiza e dëmit e të dhënave nga sateliti Copernicus Sentinel-1 nga Corey Scher of CUNY Graduate Center dhe Jamon Van Den Hoek nga Oregon State University © Financial Times

se forcat izraelite kishin shkatërruar 80% të shkollave, 70% të numrit të përgjithshëm të shtëpive dhe banesave, kishin rrafshuar të 12 universitetet në Gaza dhe kishin dëmtuar ose shkatërruar 31 nga 36 spitalet, së bashku me 195 objekte të trashëgimisë, 13 biblioteka publike, 227 xhami, tri kisha dhe Arkivat Qendrore. Forcat izraelite kanë shkatërruar gjithashtu varreza, jetimore, kampe refugjatësh, regjistra civilë, rrugë, ujësjellës kanalizime dhe impiante elektrike, dhe 70 për qind të fermave dhe tokave të pemishteve të Gazës. [3] Midis të martirizuarve janë shtresat e arsimuara dhe profesionale të Palestinës: mjekë, infermierë, reaguesit e parë, gazetarë, inxhinierë, personeli i OKB-së, akademikë dhe nëpunës civilë të saj. Deri në prill 2024 ishin vrarë rreth 5.479 studentë, 261 mësues dhe 95 profesorë universiteti.

Gjenocidi mund të realizohet gjithashtu nëpërmjet urisë, e cila i shkakton grupit të synuar "kushte të jetesës të llogaritura për të sjellë shkatërrimin e saj fizik tërësisht ose pjesërisht".

2 Moench, Mallory. «Nearly 70% of Gaza War Dead Are Women and Children, UN Says.» *BBC News*, November 7, 2024.

3 "A Cartography of Genocide: Israel's Conduct in Gaza Since October 2023." *Forensic Architecture*, October 25, 2024.

Gaza veriore, 28 dhjetor, 2023 © Yonatan Sindel

Uria e palestinezëve është rezultat i qëllimshëm i politikës zyrtare izraelite. Fushata e urisë bazohet në politikat ekzistuese të rrethimit izraelit që nga viti 2007 për të ulur zhvilluar dhe për të numëruar kaloritë e territorit të getoizuar, duke përfshirë një praktikë të gjatë të refuzimit të daljes për arsye mjekësore ose fetare dhe parandalimin e importit të furnizimeve jetike. Konkretisht që nga tetori i vitit 2023, forcat izraelite kanë krijuar epidemi urie dhe sëmundjesh me: (1) mbyllje të kalimeve veriore të Erez dhe El-Muntar dhe mbyllje periodike të kalimit kufitar Refah dhe Kerem Shalom; (2) targetimi rutinë i furrave të bukës, kuzhinave ushqimore, autokolonave të ndihmës humanitare dhe spitaleve; (3) shkatërrimi i tokave bujqësore dhe jetës bimore; (4) sulm vdekjeprurës ndaj stafit të organizatave humanitare si World Food Kitchen, Médecins Sans Frontières dhe International Rescue Committee; (5) dhe shkallëzimi logjistik dhe lejuimi i pengesave për shpërndarjen e ndihmës[4] Për shembull, midis janarit dhe shkurtit 2024, autoritetet izraelite i reduktuan flukset hyrëse të ndihmave humanitare me 50%.

Pasojat njerëzore të kësaj fushate janë të parashikueshme dhe të pranuara. Të pesë impiantet e trajtimit të ujërave të zeza të Gazës dhe shumica e 65 stacioneve të pompimit të ujërave të zeza u detyruan të mbylleshin deri në nëntor 2023. [5] IPC ka shpallur në mënyrë të përsëritur shkeljen e pragjeve të rënda të urisë që nga dhjetori 2023. Oxfam raportoi në prill se njerëzit në Gazën veriore mesatarisht mbijetojnë me më pak se 245 kalori në ditë. Në disa raste, mjekët detyrohen të operojnë pacientë pa anestezi. Rreth 90% e fëmijëve të vegjël dhe grave shtatzëna dhe gjidhënëse përballen me varfëri të madhe ushqimore. Global Nutrition Cluster vlerësoi në shkurt 2024 se 1 në 6 fëmijë në Gazën veriore janë të kequshqyer në mënyrë akute dhe se 90% e fëmijëve nën pesë vjeç kanë të paktën një sëmundje infektive. Autoritetet shëndetësore dokumentojnë shpërthime të rënda dhe të paprecedentë të diarresë, kolerës, poliomielitit, sepsisit, hepatitit, verdhëzës dhe dizenterisë. Në qershor 2024, Save the Children raportoi se rreth 20,.000 fëmijë janë tani jetimë. Mijëra fëmijë janë gjithashtu me gjymtyrë të amputuar[6] Duke vëzhguar shkatërrimin, zyrtarët izraelitë janë mjaft të kënaqur. “Unë personalisht jam krenare për rrënojat e Gazës”, tha ministrja izraelite e kabinetit May Golan në shkurt 2024, “që çdo foshnjë, edhe pas 80 vjetësh, do t’u tregojnë nipërve dhe mbesave të tyre se çfarë bënë çifutët”.

Gjenocidi shoqërohet shpesh me spastrim etnik – largim sistematik, i detyruar i grupeve etnike, racore ose fetare nga një zonë e caktuar. Kjo mund të arrihet përmes mjeteve të drejtpërdrejta, të tilla si dëbimi, ose metodave indirekte që synojnë ta detyrojnë grupin viktimë të arratiset duke parandaluar kthimin e tij, si:

4 Shihni filmin e Al-Jazeera, *Starving Gaza* me Hind Hassan, 29 shtator, 2024.

5 «The Siege of Gaza’s Water.» Center for Strategic and International Studies, 12 janar, 2024.

6 Griswold, Eliza. “The Children Who Lost Limbs in Gaza.” The New Yorker, 21 mars, 2024.

> *"Ne jemi të rrethuar nga të gjitha anët dhe njerëzit nuk dinë se ku të shkojnë. Qyteti i është nënshtruar shkatërrimit masiv të ndërtesave dhe infrastrukturës, në përpjekje për t'i detyruar banorët e mbetur të largohen. Nuk ka ushqim e ujë dhe aktualisht po përballemi me një zi të vërtetë buke. Ky* është një gjenocid ndaj banorëve dhe njerëzve të z*hvendosur që janë strehuar këtu".* – Ali Hamude, banor i Bejt Lejhies, nëntor 2024.

vrasje, përdhunim dhe shkatërrim i pronës. Spastrimi etnik është gjithashtu politika izraelite në Gaza. Në një 'dokument koncept' të rrjedhur në publik, një ministri izraelite krijoi plane për t'i dëbuar 2.3 milionë palestinezët e Gazës në shkretëtirën e Sinait, por u kundërshtua nga Egjipti në fund të tetorit 2023. Forcat izraelite që atëherë kanë urdhëruar evakuimin e 1.5 milionë palestinezëve në jug, duke rënë fletëpalosje që shpallin se: "ti (civil) do të vdesësh për asgjë", se kushdo që mbetet në veri: "mund të përcaktohet si bashkëpunëtor në një organizatë terroriste" dhe se ata në Han Junis duhet të largohen ose të vriten.[7] Gati 1.9 milionë palestinezë në Gaza janë të zhvendosur, duke përfshirë familjet e afërta të studentëve të MIT.

Në tetor 2024, ushtria izraelite u lëshoi urdhra 400.000 palestinezëve në veri të Gazës që të arratiseshin ose të vriteshin si pjesë e "planit të gjeneralëve" për "spastrimin" e palestinezëve në veri, përqendrimin e atyre që mbeten në zona të mbyllura ushtarake dhe nënshtrimin e tyre ndaj urisë deri në vdekje.[8] Për 40 ditë, pothuajse asnjë ushqim nuk ka mundur të hyjë në veri të Gazës sipas OKB-së.[9] Forcat izraelite kanë vrarë gazetarë, kanë djegur furra buke dhe spitale dhe kanë kryer masakra.

Kjo e fundit është realizuar me zjarr tankesh, sulme ajrore, dronë të armatosur dhe marshime vdekjeje.[10] Më 6 nëntor 2024, gjeneralët e IDF-së (FMI) u konfirmuan gazetarëve se "nuk ka kurrfarë qëllimi për t'i lejuar banorët e Rripit verior të Gazës të kthehen në shtëpitë e tyre" dhe se asnjë ndihmë humanitare nuk do të lejohet të hyjë në veri, pasi aty "nuk kanë mbetur më civilë"[11]

Politikat izraelite të spastrimit etnik, krimeve të luftës dhe gjenocidit janë të dokumentuara nga trupat izraelite. Për shembull, ushtarët luftarakë izraelitë pranuan në mediat hebraike në korrik 2024 një politikë të "ekzekutimeve të përmbledhura" dhe se "është e lejueshme të qëllosh të gjithë, një vajzë të re, një grua të moshuar".[12] Kufomat e civilëve të lëna të kalben ose të hahen nga kafshët endacake më pas fshihen nga pamja, përpara mbërritjes së autokolonave ndërkombëtare të ndihmës, në mënyrë që "të mos bëhen publike imazhet e njerëzve në faza të avancuara të kalbjes". Kjo shoqëron një politikë të komandantëve të ushtrisë për të shkatërruar shtëpitë dhe xhamitë palestineze me zjarr, buldozerë D-9 ose IED. "Para se të largoheni, digjni shtëpinë – çdo shtëpi", u tha një komandant vartësve të tij. "Kjo është e mbështetur në nivelin e komandantit të batalionit. Kjo është kështu që ata të mos mund të kthehen." Aktet e plaçkitjes, rrënimit, urisë, lakuriqësisë së detyruar, privimit nga gjumi, rrahjes dhe përdhunimeve në grup të palestinezëve janë dokumentuar mjaft nga vetë ushtarët izraelitë, si dhe nga gazetarët trima të Palestinës.[13]

7 «Israeli Army Threats Ordering Residents of Northern Gaza to Leave May Amount to War Crimes.» *Amnesty International*, 25 tetor, 2023.

8 «Israel Plan to Expel Palestinians from North Gaza 'Could Last Several Months'.» *Middle East Eye*, 11 tetor, 2024.

9 «Virtually no aid has reached besieged north Gaza in 40 days, UN says.» *BBC*, 20 nëntor, 2024.

10 Idan, L. «Exterminate, Expel, Resettle: Israel's Endgame in Northern Gaza.» *+972 Magazine*, November 1, 2024.

11 Bethan McKernan and William Christou. «Palestinians Will Not Be Allowed to Return to Homes in Northern Gaza, Says IDF.»

12 Reiff, Ben. "'I'm Bored, so I Shoot': The Israeli Army's Approval of Free-for-All Violence in Gaza." *+972 Magazine*. July 8, 2024. *The Guardian*, November 6, 2024.

13 Sanders, Richard. «What Did Al Jazeera's Investigation into Israeli War Crimes in Gaza Reveal?» *Al Jazeera*, 3 tetor, 2024. Shih gjithashtu mbrojtjen e ushtarit të IDF-së për përdhunimin në grup në Sde Teiman si dhe raportin e OKB-së A/79/232 (11 shtator, 2024).

Qëllimi

Gjenocidi është në fund të fundit një krim i qëllimshëm. Ai shpesh justifikohet me arsyetimin e së drejtës koloniale, sigurisë kombëtare dhe hakmarrjes. Deklaratat që bëjnë thirrje për shfarosjen dhe dëbimin e jetës palestineze në Gaza bëhen në të gjitha nivelet e qeverisë izraelite dhe formojnë politikën izraelite. Ato përfshijnë: Presidentin, Kryeministrin, Ministrat e Sigurisë Kombëtare dhe të Mbrojtjes, anëtarët e Knesset-it, gjeneralët dhe personelin ushtarak. Për shembull, më 9 tetor 2023, Ministri i Mbrojtjes Yoav Gallant i quajti gazanët "kafshë njerëzore" dhe njoftoi një rrethim të plotë të Gazës – "pa energji elektrike, pa ushqim, pa ujë, pa karburant". Ai sqaroi: "Ne do t'i japim fund gjërave brenda Gazës [...]. Unë i kam hequr të gjitha kufizimet, [juve ju lejohet të] sulmoni gjithçka. Ne do të eliminojmë gjithçka". Presidenti Isaac Herzog fajësoi "të gjithë kombin" e Palestinës për sulmin e Hamasit. Llogaria zyrtare e mediave sociale për shtetin e Izraelit njoftoi se "nuk ka civilë të pafajshëm" në Gaza. [14]

Skenë nga Gaza bashkëkohore në *From Ground Zero* (2024)
© Rashid Masharawi

Gjenocidi është parapëlqimi i zbuluar i anëtarëve me ndikim të koalicionit qeverisës të udhëhequr nga Likud. Ministri i Arsimit bëri thirrje për një "Nakba të dytë". Ministri i Sigurisë Kombëtare deklaroi në televizionin kombëtar se të gjithë palestinezët dhe familjet e tyre që mbështesin çdo rezistencë të armatosur kundër Izraelit janë "të gjithë terroristë dhe ata gjithashtu duhet të shkatërrohen" dhe se Gaza, pas shpopullimit të saj, duhet të ripopullohet me çifutë izraelitë. Ministri i Energjisë njoftoi se "e gjithë popullsia civile në Gaza është urdhëruar të largohet menjëherë... nuk do të marrin asnjë pikë ujë apo një bateri të vetme derisa të largohen nga bota". Ministri i Trashëgimisë mbështeti hedhjen e një bombe atomike në Gaza duke thënë se "nuk ka gjë të tillë si civilë të papërfshirë në Gaza". Parlamentarët e zgjedhur izraelitë kanë bërë thirrje që Gaza të "rrafshohet", "të lihet në uri", "të fshihet" dhe "të lihet në etje". Dëshira e zyrtarëve të kabinetit për gjenocid ndikon në politikën shtetërore. "Kam njerëz në kabinet që nuk duan as një aspirinë të futet në Gaza për shkak të asaj që ka ndodhur", thuhet se kryeministri i tha Sekretarit të Shtetit të SHBA në mbrojtje të politikës së Izraelit për urinë, "këta janë njerëzit në koalicionin tim".[15]

Mbrojtjet zyrtare të gjenocidit thirren në nocionet manikeiane të "detyrës biblike" dhe "sigurisë kombëtare". Më 28 tetor, kryeministri Benjamin Netanyahu e cilësoi pushtimin e tij tokësor të Gazës si "një qëllim suprem: Të shkatërrohet armikun vrasës", duke i vënë "fëmijët e dritës" kundër "fëmijëve të errësirës". Ai e përshkroi Gazën si "qytetin e së keqes, ne do t'i kthejmë në gërmadha të gjitha vendet ku Hamasi vendoset dhe fshihet". Ai citoi vargun Devarim 25:17 në një letër drejtuar ushtarëve, e cila përfundon me një nxitje: "të fshini kujtimin e Amalekut nga nën qiej". Ky varg shpesh kuptohet si një urdhër hyjnor për të vrarë çdo pasardhës të popullit amalekit.

14 Shih Law for Palestine, Database of Israeli Incitement to Genocide (Ligji për Palestinën, Baza e të dhënave për nxitjen izraelite për gjenocid) (15 janar, 2024).

15 Foer, Franklin. «Biden and Netanyahu›s War: The Dangers of Being Too Close.» *The Atlantic*, 25 shtator, 2024.

Qëllimi

Fragmenti përkatës biblik thotë si vijon: **“Tani pra, sulmoje Amalekun e shfaros gjithçka që gjendet në të. Mos ki mëshirë. Vriti me burra, gra, fëmijë, foshnja gjiri...”**. [16] Ministri i Financave Bezalel Smotrich e përsëriti këtë ndjenjë në prill 2024: “Nuk ka masa gjysmake… Refah, Dejr el-Balah, Nuseirat – asgjësim total. ‘Ti do ta fshish kujtimin e Amalekut nën qiell’”. Në gusht, ministri i financave tha se: “mund të jetë e justifikuar dhe morale” të “vriten urie 2 milionë njerëz”, duke shprehur keqardhje që bota nuk do ta lejojë këtë.

Qëllimi gjenocidal shprehet nga anëtarë të lartë të forcave të armatosura izraelite. Më 9 tetor, gjeneralmajori i IDF-së Giora Eiland, ish-kreu i Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Izraelit dhe këshilltar i ministrit të mbrojtjes, shkroi në gazetën e përditshme Yedioth Ahronoth se “Gaza do të bëhet një vend ku asnjë qenie njerëzore nuk mund të ekzistojë” dhe se “krijimi i një krize të rëndë humanitare në Gaza është një mjet i domosdoshëm për arritjen e qëllimit”. Ai vazhdoi: “Njerëzve duhet t’u thuhet se ata kanë dy zgjedhje: të qëndrojnë dhe të vdesin urie, ose të largohen”. Në tetor 2023, zëdhënësi i IDF, Daniel Hagari, tha se: “ne po hedhim mijëra tonelata municione në Gaza... Jemi të fokusuar në atë që shkakton dëme maksimale”. Shefi i rabinatit ushtarak Eyal Krim, i cili më parë këshilloi se ushtarët çifutë mund të kënaqin ‘shtytjen e ligë’ seksuale ndaj grave joçifute të zëna rob, u zotua për “dëm të pakompromis mbi armikun” në mënyrë që të sigurojë “kontroll të fortë në tokën e të parëve tanë”.[17]

Politika gjenocidale e motivuar nga hakmarrja kuptohet lart e poshtë zinxhirit komandues. Kolonelët izraelitë që udhëhoqën trupat në Bejt Lehia i thanë TV izraelite më 4 nëntor 2023 se Gaza duhet bërë “një tokë djerrë”, një “tokë e djegur”, e pajetueshme dhe pa të ardhme. “Duhet hakmarrë për atë që na bënë... pas 100 vitesh ata do ta dinë se nuk duhet të ngatërrohesh me çifutët”. Një tjetër gjeneral brigade deklaroi: “ne do ta bëjmë pluhur e hi çdo parcelë toke të mallkuar nga erdhi [armiku], do ta shkatërrojmë atë dhe kujtimin e tij ... dhe nuk do të kthehemi derisa të asgjësohet”. Në shkurt 2024, Komandanti i Përgjithshëm i IDF, Hatsef Hallevi, tha: “ne nuk duam ta lëmë Refahun me infrastrukturën e tij të paprekur”.[18] Qëllimi gjenocidal është në përputhje me “Doktrinën Dahya” të ushtrisë izraelite që ekziston për një kohë të gjatë. siç është përshkruar nga Gadi Eisenkot, Shefi i Shtabit të Forcave të Mbrojtjes të Izraelit nga 2015-2019 dhe ministër aktual në nivel kabineti, i cili bën thirrje për shkatërrimin në shkallë të gjerë të infrastrukturës dhe strehimit civil dhe si një taktikë për të minuar armiqtë e Izraelit. Në nëntor 2024, një komandant i divizionit të IDF që vepron në Gazën veriore u shpjegoi gazetarëve të “Haaretz”-it: “Askush nuk kthehet në pjesën veriore...Ne morëm urdhra shumë të qarta. Detyra ime është të bej një spastrim të zonës”.

16 1 Samuelit 15:3 . Shih Rosen, Maya. «Facing Amalek.» *Jewish Currents*, March 22, 2024.

17 Karim, Eil. “The Victory of the Spirit of the IDF Soldiers: They Are Willing to Go into a Battle That Has No Morality” [Hebrew]. *Israel Hayom*, October 19, 2023.

18 Zitun, Yoav. “IDF Chief in Gaza: ‹We›ve Killed Over 900 Terrorists in Rafah, We›re Wearing Down Hamas.” Ynet News, February 7, 2024.

Qëllimi

Qëllimi gjenocidal nuk është i kufizuar në nivelin zyrtar elitar, por është i përqafuar brenda shoqërisë çifute izraelite. Ushtarët e zakonshëm këndojnë për "fshirjen e farës së Amalekut" dhe "u djegtë fshati juaj!" Në tetor 2023, ushtria bëri një platformë për një oficer dhe rekrutues moral që do t'i nxiste trupat për t'i "fshirë ata, familjet e tyre, nënat dhe fëmijët" dhe duke thënë: "këto kafshë nuk mund të jetojnë më... Çdo çifut me armë duhet të dalë dhe t'i vrasë ata. Nëse keni një fqinj arab, mos prisni, shkoni në shtëpinë e tij dhe qëllojeni atë". Thirrjet për të "fshirë" dhe "rrafshuar" Gazën përsëriten në shtypin izraelit, televizionin kryesor si Channel 12 dhe 14, si dhe Tiktok, X, aplikacionet e Meta-s dhe Telegram[19]



Mehdi Kerira, artist me kukulla në Gaza, qershor 2024 © Amjad Al Fayoumi | Sama Quds

Një zhanër i ri i muzikës "pop gjenocidi" përfshin këngën Harbu Darbu, e cila arriti numrin 1 në platformat e transmetimit në Izrael dhe bën thirrje për vdekjen e palestinezëve në Gaza. Kënga ka vargje që thonë: "Prisni të bjerë si shi mbi ju, kurva", "ju tufa minjsh të ndyrë", dhe i referohet palestinezëve si "fëmijët e Amalekut"[20] Ylli izraelit i popit Lior Narkis vizitoi bazat e ushtrisë duke kënduar "Gaza, ti grua e zezë, plehrë" dhe "ti kurvë, ti bijë e një prostitute të trashë". Këto anekdota janë manifestime vulgare të një tendence më të përhapur të dehumanizimit dhe pëlqimit të fabrikuar që shtrihet deri në shoqërinë "e sjellshme".[21] Për shembull, 94% e izraelitëve çifutë të anketuar në nëntor 2023 besonin se Izraeli është duke përdorur mjaft ose shumë pak fuqi zjarri në Gaza.[22] Në shkurt 2024, 68% e izraelitëve çifutë të anketuar kundërshtonin "bartjen e ndihmave humanitare për banorët e Gazës".[23]

Rinad Attallah, 10-vjeçare në Gaza, tetor 2024 © Renad's Instagram

19 McGreal, Chris. "The Language Being Used to Describe Palestinians Is Genocidal." *The Guardian*. October 16, 2023.
20 Landler, Mark. "'Erase Gaza': War Unleashes Incendiary Rhetoric in Israel." *The New York Times*, November 15, 2023.
21 Zonszein, Mairav. "The Problem Isn't Just Netanyahu. It's Israeli Society". *Foreign Policy*, April 2, 2024.
22 Gordon, Anna. "What Israelis Think of the War With Hamas." *Time*, November 10, 2023.
23 Hermann, Tamar, and Yaron Kaplan. "Most Israelis: An «Absolute Victory» to the War Is Unlikely." *The Israel Democracy Institute*, February 20, 2024.

Njohja

Fakti që shteti i Izraelit po kryen gjenocid në Gaza është njohur nga autoritetet e larta në komunitetin akademik dhe të të drejtave të njeriut. Këtu përfshihen Amnesty International, Lemkin Institute for Genocide Prevention (Instituti Lemkin për Parandalimin e Gjenocidit), Euro-Mediterranean Human Rights Monitor (Monitoruesi Euro-Mesdhetar i të Drejtave të Njeriut), Forensic Architecture (Arkitektura e Mjekësisë Ligjore), Center for Constitutional Rights (Qendra për të Drejtat Kushtetuese) dhe dy ish-drejtues të Human Rights Watch: Kenneth Roth dhe bashkëthemeluesi i saj dhe ish-drejtori kombëtar i ACLU Aryeh Neier.[24] Studiuesit izraelitë të holokaustit Raz Segal, Omer Bartov, Lee Mordechai dhe Amos Goldberg i kanë vlerësuar veprimet izraelite në Gaza si një përpjekje për gjenocid.[25] Ata i bashkohen 55 studiuesve dhe ekspertëve të çështjeve mbi gjenocidet në: Armeni, Kamboxhia, Ruandë, Bosnjë, Ukrainë, Namibi dhe Amerikën e Veriut. Realiteti i gjenocidit në Gaza diskutohet gjerësisht në forumet e revistave akademike si *Journal of Genocide Research* dhe *Opinio Juris*, si dhe në revista joakademike, si *Lawfare*, *Just Security*, *n+1*, *Jewish Currents*, *+972*, dhe *New Left Review*. Ata u bashkohen gazetarëve dhe studiuesve si Noura Erakat, Amira Hass, Maryam Jamshidi, Taner Akçam, Gideon Levy, Nimer Sultany, Ghousoon Bisharat, John B. Quigley, Craig Mokhiber, Arielle Angel dhe Amy Goodman.

Krimet izraelite në Gaza njihen më tej nga gjykatat ndërkombëtare dhe zyrtarët e OKB-së. Në janar 2024, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) në çështjen gjyqësore *Afrika e Jugut kundër Izraelit* nxori masa të përkohshme duke e konsideruar të besueshme që veprimet ushtarake izraelite në Gaza përbëjnë gjenocid në qëllim dhe efekt. Gjykata urdhëroi Izraelin të parandalojë gjenocidin dhe të heqë dorë nga vrasja, plagosja dhe shkatërrimi i jetës palestineze. Akuza për gjenocid është ngritur gjithashtu nga shoqëria civile palestineze, si Qendra Palestineze për të Drejtat e Njeriut, Qendra El Mizan për të Drejtat e Njeriut dhe El-Hak.

Dëbimi i palestinezëve nga veriu i Gazës, tetor 2024

Në fund të shkurtit 2024, Human Rights Watch dhe Amnesty International pohuan se Izraeli kishte dështuar t'iu bindej masave të përkohshme të GJND-së dhe se pengimi i flukseve të ndihmës përbënte krime lufte. Në maj, GJND vendosi se pushtimi i vazhdueshëm i Refahut shkel të drejtën e palestinezëve për siguri dhe duhet të ndalojë menjëherë. Ky urdhër u shpërfill. Më 21 nëntor 2024, Gjykata Penale Ndërkombëtare (ICC) lëshoi urdhra arresti për kryeministrin izraelit dhe ministrin e mbrojtjes për: "krimin e luftës të urisë si një metodë lufte; dhe krimet kundër njerëzimit të vrasjeve, persekutimit dhe akteve të tjera çnjerëzore". **Në dhjetor 2024, Amnesty International publikoi 296 faqe prova që arrinin në përfundim se veprimet e qeverisë izraelite në Gaza përbëjnë gjenocid**.

24 Neier, Aryeh. "Is Israel Committing Genocide?" *The New York Review*, June 6, 2024.

25 Goldberg, Amos. "Yes, It›s Genocide". [Hebrew] *Local Call*, April 17, 2024.

Njohja

Në një raport special “Anatomia e Gjenocidit”, Francesca Albanese, Raportuesja Speciale e OKB-së për situatën e të drejtave të njeriut në territoret palestineze të pushtuara që nga viti 1967, arriti në përfundimin se Izraeli po kryente akte gjenocidi. Në tetor 2024, UNHCR publikoi një raport që akuzonte ushtrinë izraelite për “krimin kundër njerëzimit të shfarosjes” për vrasjen e punonjësve shëndetësorë dhe shënjestrimin e objekteve shëndetësore. Politikat izraelite të gjenocidit, pushtimit dhe urisë deri në vdekje në Palestinë janë njohur globalisht nga qeveritë kombëtare. USAID dhe Departamenti i Shtetit arritën në përfundim në prill 2024 se autoritetet izraelite pengonin në mënyrë rutinë shpërndarjen e ushqimit dhe të ilaçeve. Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Josep Borrell, pohoi në mars 2024 se “uria po përdoret si një armë lufte” nga Izraeli.

Tridhjetë e katër qeveri iu bashkuan çështjes gjyqësore të Afrikës së Jugut kundër gjenocidit izraelit në GJND, si edhe Bashkimi Afrikan, Liga Arabe, Organizata e Bashkëpunimit Islamik dhe aleatët e pasur dhe demokratikë të Shteteve të Bashkuara si Spanja dhe Irlanda. Në korrik 2024, GJND-ja vendosi në një opinion këshillues si pikë referimi se pushtimi i vazhdueshëm i Palestinës nga Izraeli është i paligjshëm. Në shtator 2024, asambleja e përgjithshme e OKB-së votoi me shumicë dërrmuese (194-14) për t’i bërë thirrje Izraelit që “t’i tërheqë të gjitha forcat e tij ushtarake nga Territori i Pushtuar Palestinez”. Përsëri votat “po” nuk u kufizuan vetëm në shtetet e pas-pavarësisë në Azi, Afrikë dhe Amerikën e Jugut, por erdhën nga aleatë të pasur, demokratikë të Shteteve të Bashkuara, si: Japonia, Islanda, Finlanda, Norvegjia, Franca, Irlanda, Portugalia, dhe Belgjika.

Tubim për t’i dhënë fund bashkëfajësisë së MIT në gjenocid, 2 mars, 2024.

Nakba dhe kolonializmi i kolonëve

Shoqëri pune e rinisë Beitar (cionistë revizionistë) në afërsi të Hadera, 1932 © Aleksandrovich Ze'ev

Të rinj djathtistë izraelitë duke vrapuar për t'i ndalur kamionët me ndihma të futen ne Gaza, 2024 © Lorenzo Tugnoli | Washington Post

Seksioni 1.2 Nakba dhe kolonializmi i kolonëve

"Ky është një kolonializëm unik të cilit ne i jemi nënshtruar aty ku ata nuk kanë asnjë dobi për ne. Palestinezi më i mirë për ta ose ka vdekur ose është zhdukur. Nuk është se ata duan të na shfrytëzojnë, apo se duhet të na mbajnë atje në mënyrën e Algjerisë apo Afrikës së Jugut si nënklasë"

Edward Said, *The Pen and the Sword* (1994).

Gjenocidi në Gaza i ka rrënjët në projektin politik të Sionizmit modern, i cili iu kushtua krijimit të një atdheu kombëtar çifut në Palestinën osmane dhe më pas Palestinën me Mandatin Britanik. Sionizmi u shfaq fillimisht si një projekt rivendosës i krishterë qysh në kohën e puritanëve anglezë; ai u fuqizua në mesin e disa çifutëve evropianë, por jo fillimisht në Lindjen e Mesme apo Amerikë, si një përgjigje ndaj valëve të mëdha të antisemitizmit në Evropë në fund të shekullit të 19-të. Ai përparoi nga dritat e disa intelektualëve borgjezë (Hess, Herzl, Weizmann, Jabotinsky), nën garancitë perandorake britanike, në bashkëpunim me kapitalin e diasporës dhe të frymëzuar nga rrymat e ideologjisë nacionaliste romantike, veçanërisht në Gjermani dhe Evropën Lindore-Qendrore.[26] Pasi u krijua, Izraeli u soll shumë si do të sillej një shtet i ri kolonësh, duke lehtësuar migrimin e vazhdueshëm të bashkëetnikëve dhe duke miratuar një politikë eliminuese ndaj vendasve si patroni i tij shtet kolonësh më i vjetër – Shtetet e Bashkuara.[27]

Ky projekt politik kërkonte pushtim territorial dhe spastrim etnik. Në 1947-1948, rreth 85 për qind e arabëve të krishterë dhe myslimanë të Palestinës (afërsisht 750.000 njerëz) brenda kufijve të shtetit të deklaruar të Izraelit u dëbuan si refugjatë në atë që në arabisht quhet *Nakba*.[28] Ata pak që mbetën, shumë në qytetet veriore si Nazareti dhe Haifa ose beduinët e jugut, jetuan nën sundimin ushtarak deri në vitin 1966.

Harta "Kolonitë çifute në Palestinë" e vitit 1917

Burimi: Harry Sacher, *Zionism and the Jewish Future* (1917)

Në qershor 1967, Izraeli e zaptoi dhe më pas pushtoi Sinain, Lartësitë e Golanit, Gazën dhe Bregun Perëndimor në atë që quhet *Naksa*, duke nënshtruar popullsi të madha, të urbanizuara të palestinezëve në dy rajonet e fundit ndaj një regjimi të sundimit ushtarak që është duke zgjatur më shumë se gjysmë shekulli.

26 Halbrook, Stephen. "The Class Origins of Zionist Ideology." *Journal of Palestine Studies* 2, no. 1 (1972): 86–110.

27 See further readings for settler colonial analysis of Zionism, particularly Sayegh (2012), Shafir (1996), Pappe (2006, 2008), Khalidi (2020).

28 Për një të kuptuar më të gjerë të Nakbas si një përpjekje shekullore e zhvendosjes, luftës, gjenocidit dhe fragmentimit në Palestinë, shihni materiale të tjera, veçanërisht Eghbariah (2024), Masalha (2012, 2018), Walid Khalidi (1992), Rashid Khalidi (2020), Pappe (2007), Hadawi (1991), dhe Sa'di dhe Abu-Lughod (2007).

Në vitin 1980, Izraeli e zyrtarizoi aneksimin e Jerusalemit Lindor, duke u dhënë banorëve palestinezë të Jerusalemit një status të veçantë identiteti, pa shtetësi të plotë dhe të drejta kombëtare votimi. Në vitin 1981, Izraeli aneksoi Golanin. Sipas Marrëveshjes së Oslos të viteve 1990, Izraeli ia transferoi qeverisjen e qyteteve kryesore palestineze në territoret e pushtuara Autoritetit Kombëtar Palestinez të sapokrijuar, por mbajti rreth dy të tretat e tokës, të quajtur Zona C, për ndërmarrjen e vet ushtarake dhe të kolonëve. Pas vitit 2007 dhe planit të shkëputjes së Gazës, ushtria izraelite ndërtoi një mur ndarës përmes Bregut Perëndimor, duke shkëputur periferitë palestineze të Jerusalemit lindor nga zemra e qytetit.

Që nga vitet 1970 e deri më sot, qeveria izraelite ka lejuar dhe subvencionuar gjithashtu zgjerimin e një lëvizjeje të dhunshme të kolonëve çifutë në territoret e pushtuara. Nga kolonët Gush Emunim të viteve 1970 deri te partitë bashkëkohore të Knesset-it (Likud, Tkuma, Otzma Yehudit dhe Shtëpia Çifute), zërat më me ndikim në politikën e kolonëve përqafojnë një vizion irredentist, teokratik dhe të së djathtës ekstreme të supremacisë çifute me çdo kusht. Parlamenti izraelit ka votuar me shumicë dërrmuese për t'ua refuzuar statusin e shtetësisë palestineze në territoret e pushtuara, kurse qeveritë e njëpasnjëshme izraelite e kanë bërë të qartë synimin e tyre për të mbajtur territorin palestinez përtej Vijës së Gjelbër për një kohë të pacaktuar.

Palestinezët mbrojnë veten kundër kolonëve në Nablus Nablus, 2021
© Sakir Khader | Magnum Photos

Gaza dhe Zonat A dhe B të Bregut Perëndimor



Si me shumë projekte kolone-koloniale, projekti i kolonëve sionistë, i cili filloi edhe para vitit 1948, kërkonte jo vetëm gjenocid dhe spastrim masiv etnik, por edhe përthithjen e popullsisë vendase në një pakicë të pasivizuar. Ky proces, atë që Elia Zureik (1979) e quan kolonializëm të brendshëm, manifestohet si aparteid brenda territoreve palestineze të pushtuara që nga viti 1948 dhe 1967. Statuti i Romës e përkufizon aparteidin si një krim kundër njerëzimit, konkretisht "Veprimet çnjerëzore… të kryera në kontekstin e një regjimi të institucionalizuar të shtypjes dhe dominimit sistematik të një grupi racor mbi çdo tjetër grup ose grupe racore dhe të kryera me synimin për të ruajtur atë regjim". Kjo strukturë propagandohet nga kolonia e kolonëve për t'i kontrolluar palestinezët në të dy anët e Vijës së Gjelbër.

Regjimi izraelit i aparteidit vepron nën një sistem të shkallëzuar. Në **Shkallën 1**, qytetarëve çifutë të Izraelit u jepen të drejta të plota civile dhe pronësore, duke përfshirë aftësinë për të zaptuar tokë në territoret e pushtuara më 1967, si dhe për të blerë tokë nga Fondi Kombëtar Çifut, i cili kontrollon 13% të tokës së pushtuar më 1948. Në **Shkallën 2**, qytetarëve palestinezë të Izraelit u ndalohet të blejnë tokë nga ky fond, duke ndaluar pronësinë e tokës në mbi 900 lokalitete. Ata nuk mund të fitojnë të drejtat e nënshtetësisë për anëtarët e familjes si brenda territoreve të pushtuara të vitit 1967, ashtu edhe jashtë tyre, dhe shpesh përballen me dhunë ndëshkuese gjatë protestave, si në Ditën e Tokës të vitit 1976, kur qindra palestinezë u plagosën dhe 6 u vranë nga forcat pushtuese ndërsa protestonin kundër konfiskimit të 20.000 dynymëve tokë në Galile. Këta dy milionë qytetarë jetojnë nën mbikëqyrjen e shtuar të shtetit, shumë syresh në komunitete që vuajnë nga braktisja e organizuar dhe 'judaizimi' i planifikuar.

Shkalla 3 përbëhet nga komunitete palestineze beduine që nuk janë të njohura nga pushtuesi, por që kanë ekzistuar më gjatë se vetë lëvizja sioniste. Këtyre palestinezëve u mohohet qasja në energjinë elektrike, rrjetet e ujit, kanalizimet dhe transportin publik dhe përballen me shembjet rutinë të shtëpive – në maj 2024, për shembull, forcat izraelite shembën 47 shtëpi në Vadi el-Halil, duke zhvendosur mbi 300 beduinë palestinezë. **Shkalla 4** përmban palestinezë që jetojnë në Jerusalem (el-Kuds), të cilëve u mohohet zyrtarisht e drejta e votës dhe nënshtetësia, dhe në praktikë u mohohen lejet për ndërtim me një përqindje refuzimi prej 93%. Kjo politikë i detyron palestinezët të ndërtojnë dhe rinovojnë shtëpi pa leje, duke i bërë 85% të shtëpive të tyre në el-Kuds të paligjshme sipas ligjit të aparteidit të kolonëve. Familjet palestineze gjithashtu përballen me dëbime të papritura sipas "Ligjit të Pronës së të Munguarve" i cili u lejon çifutëve të zaptojnë pronat palestineze, të tilla si dëbimet e Shejhh Xherrah në vitin 2021 që nxitën Intifadën e Unitetit. Palestinezët nuk kanë asnjë mjet ligjor të barasvlershëm me Ligjin e Pronësisë së të Munguarve.

Palestinezë ngjiten Murit të Ndarjes për t'u falur në Jerusalem

© Hisham Ebu Shekreh, Ramazan 2023

Shkallët 5, **6** dhe **7** përkojnë me palestinezët në zonat A, B dhe C të Bregut Perëndimor, të cilat janë nën pushtimin ushtarak izraelit dhe qeverisjen neokoloniale të një Autoriteti Palestinez alla-Bantustan, i cili nënkontrakton për autoritetet okupuese. Palestinezët në këto shkallë përballen me kufizime edhe më të rënda në lirinë e lëvizjes, fjalës, tubimit, fesë dhe qëndrimit; ata mbikëqyren nga postblloqe, dronë dhe kulla vrojtimi; ata i nënshtrohen ligjit ushtarak izraelit ndërsa kolonëve çifutë u dhurohet ligji civil izraelit; kurse komunitetet e tyre janë ndarë dhe getoizuar nga rrugët hyrëse "vetëm për izraelitë". **Shkalla 8** përkon me palestinezët në Rripin e Gazës, të cilët kanë qenë subjekt i sulmeve dhe pushtimit izraelit që nga viti 1948, duke përfshirë bllokadën e udhëhequr nga Izraeli të kufijve, detit dhe hapësirës ajrore të tyre.

Realiteti i aparteidit izraelit është vërtetuar nga grupet e të drejtave të njeriut në Palestinë si El-Hak, Bedil, Amnesty International dhe Human Rights Watch. Ne përmendim realitetet e aparteidit për të kapur përmasat e mëtejshme të përvojës palestineze nën kolonializmin e brendshëm, i cili është një zgjatim i projektit të kolonëve sionistë dhe një përjetësim i spastrimit etnik dhe gjenocidit të filluar gjatë Nakbas të vitit 1948.

Një familje në Gaza duke pastruar perime, rreth viteve 1940-1970. © Kegham Djeghalian

Sulmet e 7 tetorit, lufta që pasoi në Gaza dhe zgjerimi i saj në Liban ekzistojnë kështu në një kontekst kolonial. Shoqëritë si ajo e Izraelit nuk katandisen në ahengje fashiste brenda natës dhe as grupet e armatosura të rezistencës si Hamasi nuk mund të rekrutojnë lehtësisht nga popujt e shtypur pa shterimin e alternativave të tjera: thirrje morale, aktivizëm ligjor, greva të punës, mosbindje civile, protesta masive dhe negociata diplomatike. Konteksti i luftës në Gaza është 75 vjet aparteid dhe më shumë se një shekull kolonializëm ardhacakësh. Ajo është gjithashtu 56 vjet pushtim ushtarak dhe kolonizim në Bregun Perëndimor dhe një bllokadë 16-vjeçare e Rripit të Gazës. Palestinezët kanë të drejtë t'i rezistojnë këtij pushtimi me forcën e armëve sipas Protokollit I të Konventave të Gjenevës. Kjo çështje nuk është një opinion i njëanshëm apo elegancë radikale, por është një domosdoshmëri analitike për të kuptuar atë që Tareq Baconi e quan "ekuilibri i dhunshëm" në Palestinë sot.[29]

Vetë Rripi i Gazës duhej të krijohej përmes dhunës së organizuar. Qytezat palestineze përgjatë rrafshit bregdetar mesdhetar: Gaza, Refah, Han Junis dhe Dejr el-Balah – janë të vjetra dhe kanë një histori të pasur. Megjithatë, më shumë se 67% e popullsisë së Gazës që nga maji i vitit 2023 ishin refugjatë të përqendruar rreth 8 kampeve të refugjatëve të UNRWA-s dhe pasardhës të atyre palestinezëve të dëbuar nga autoritetet sioniste në fushatat e spastrimit etnik të viteve 1947-1948, ose Nakbas. Ndër barrierat e para që demarkuan kufirin e Gazës ishte një gardh i ngritur nga Ariel Sharon në vitin 1971 për të kufizuar popullsinë palestineze dhe për të ndëshkuar sulmet nga fedajinët që bënin agjitacion për kthim. Gardhi hapi rrugën për planet për të 'judaizuar' enklavën sipas Planit Eshkol të Agjencisë Çifute. Përpjekjet izraelite për të shpopulluar Gazën janë të vjetra. Ato përfshinin plane gjatë dhe pas pushtimit të Gazës në vitin 1956 për të blerë tokë nga kolonët italianë në Libi dhe për të vendosur të dëbuar palestinezë shumë larg Palestinës, si dhe masakra të kryera në koordinim me imperialistët britanikë dhe francezë.

29 Shih Baconi, Tareq. 2018. *Hamas Contained: The Rise and Pacification of Palestinian Resistance.* Stanford University Press.

Në vitin 1994, kryeministri Yitzhak Rabin e zëvendësoi gardhin e thjeshtë me një pengesë të sigurisë së lartë të kamerave, sensorëve dhe "pikave hyrëse dhe dalëse të teknologjisë së lartë" si pjesë e një politike të re ndarjeje ose hafrada midis popullatave. Në vitin 2005, qeveria izraelite evakuoi me forcë kolonët e saj nga Gaza, me qëllimin e deklaruar të "ngrirjes së procesit të paqes". Sipas fjalëve të këshilltarit të lartë të kryeministrit Ariel Sharon: "kur e ngrini atë proces, ju parandaloni krijimin e një shteti palestinez dhe parandaloni një diskutim për refugjatët, kufijtë dhe Jerusalemin". Ose sipas fjalëve të kryeministrit Ehud Olmert, qëllimi i shkëputjes ishte të parandalonte ndryshimin e "thelbit të konfliktit nga një paradigmë algjeriane në atë të Afrikës së Jugut. Nga një luftë kundër 'pushtimit', në gjuhën e tyre, në një luftë për – një njeri-një votë".[30]

Dekadat që nga viti 2005 janë modeluar nga luftëra asimetrike, shkatërruese në Gaza (2008, 2012, 2014, 2021), ku Hamasi palestinez udhëheq rezistencën e armatosur të organizuar ndaj sundimit izraelit. Bllokada dhe fushatat e bombardimeve izraelite e kanë lënë Gazën gjithnjë e më të varfër dhe të pajetueshme. Që nga fillimi i viteve 2000, Izraeli krijoi një arkitekturë sigurie që do t'i lejonte atij t'i ndante dhe zaptonte territoret e pushtuara në vitin 1967 dhe të parandalonte shfaqjen e një shteti palestinez. Basti i nënkuptuar i sundimtarëve të krahut të djathtë të Izraelit ishte se kostoja e këtyre luftërave do të ishte mjaft e vogël për t'u injoruar nga publiku izraelit dhe se palestinezët, të mbyllur pas betonit dhe gardheve, mund të injoroheshin përgjithmonë.

Këto luftëra vlerësohen nga patronët ndërkombëtarë të Izraelit dhe media perëndimore sipas një standardi tipik të dyfishtë kolonial: se çdo dhunë palestineze është akt *sui generis* i një të egri, jo i një aktori politik të kufizuar që vepron në ndarjet manikeiane të kolonisë së ardhacakëve. Në këtë kuadër kolonial, asnjë dhunë izraelite nuk justifikon kurrë ndonjë dhunë palestineze dhe sionistët kanë një të drejtë të hekurt për vetëmbrojtje, por palestinezët nuk kanë asnjë të drejtë.

Ky ishte statusi në prag të sulmit të Përmbytjes El-Aksa të 7 tetorit që vrau disa qindra civilë izraelitë dhe disa qindra ushtarë. Deri më 6 tetor, ky kishte qenë tashmë viti më vdekjeprurës për fëmijët palestinezë.[31] Ai përfshinte avancimet fetare sioniste në El-Aksa në Jerusalem, pogromin e kolonëve në Huvera dhe prishjet, sekuestrimet e pronave dhe ndalimet pa gjyq rekorde në Bregun Perëndimor. Për një shoqëri gjithnjë e më reaksionare izraelite, zgjidhja e "problemit palestinez" nuk ishte më një temë e tryezës së kuzhinës. Një mur i militarizuar e mbylli Gazën, duke ia zënë frymën jetës brenda saj.

Establishmenti i sigurisë besonte se Hamasi ishte mposhtur deri në nënshtrim nga 16 vjet bllokadë nga toka, ajri dhe deti, së bashku me bombardimet rutinë dhe masakrat për të "kositur barin". Muret, pikat e kontrollit dhe rrugët e qasjes vetëm për çifutët i larguan palestinezët nga shikimi i kolonëve, ndërsa aneksimi i shkallëshkallshëm i territorit të pushtuar lëvizi ngadalshëm pa ndonjë pasojë reale nga patronët e Izraelit. SHBA nën presidentët Donald Trump dhe Joseph Biden u pajtuan me njohjen e Jerusalemit të aneksuar si kryeqytetin e Izraelit, ndërsa shtetet e Ligës Arabe si Arabia Saudite ishin në prag të braktisjes së Iniciativës Arabe të Paqes në favor të normalizimit me shtetin e aparteidit.

30 Landau, David. "‹Maximum Jews, Minimum Palestinians.›" *Haaretz*, November 13, 2003.

31 Muaddi, Qassam. "'2023 Is ‹Deadliest Year› for Palestinian Children, Say Human Rights Groups.'" *The New Arab*, October 6, 2023.

Ekonomia politike dhe gjenocidi

Sulmet ajrore izraelite godasin ndërtesën Kulla Palestineze në Gaza, tetor 2023 © Mahmud Hams | AFP

Ovacione në këmbë nga Kongresi Amerikan për kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu, korrik 2024 © Justin Sullivan | Getty Images

Seksioni 1.3 Ekonomia politike dhe gjenocidi

Në shikim të parë, gjenocidi në Gaza mund të duket se është kryer kryesisht nga koalicioni qeverisës Likud, pa përfshirje të drejtpërdrejtë nga Shtetet e Bashkuara ose institucionet arsimore si MIT.[32] Trupat izraelite janë në masë të madhe qytetarë izraelitë. Izraelitët kanë një bazë industriale ushtarake të zhvilluar (firma si Elbit Systems, Taas, IAI dhe Rafael), dhe tregjet e thella izraelite të kapitalit i lejojnë koalicionit qeverisës të financojë shumicën e modeleve të tij të dhunshme në nivel lokal: Për vitin 2024, rreth 70% e 60 miliardë dollarëve sa shteti i emetoi si borxhe u shit në tregjet e brendshme izraelite dhe u shpreh në monedhën e Shekelit të Ri Izraelit (NIS). Për shkak të kërkesës së lartë nga bankat vendase, qeveria e koalicionit nuk është në rrezik të mospagimit dhe nuk duhet të paguajë norma të larta interesi për këto borxhe vendore. Banka e saj qendrore mund të ofrojë obligacione konkurruese me bonot e thesarit të emetuara nga Thesari i SHBA-së. Rezervat valutore të mbajtura në Bankën e Izraelit arritën në 200 miliardë dollarë në janar 2024, duke stabilizuar më tej pamjen makro-ekonomike të ekonomisë së luftës. Partneri më i madh i zonës tregtare të Izraelit nuk janë Shtetet e Bashkuara, por Bashkimi Evropian, kurse aleatët e jashtëm si India dhe Nepali janë furnizues të gatshëm të ushtrive rezervë të punës për t'i zëvendësuar palestinezët.

Realiteti është se **shkaktimi i dhunës me përmasa gjenocidale kërkon vëllime municionesh shumë më tepër se sa kapaciteti i bazës industriale izraelite për të prodhuar në nivel vendor**. Për më tepër, Izraeli nuk mund t'i shkatërrojë Gazën dhe Libanin pa u ndëshkuar, pa pasur një mbulim të konsiderueshëm diplomatik dhe ushtarak të siguruar nga një superfuqi si Shtetet e Bashkuara, dhe as që mund të sigurojë veten financiarisht pa investime dhe teknologji të konsiderueshme amerikane. Kështu, **aftësia e shtetit izraelit për të bërë luftë kundër Palestinës pa u ndëshkuar buron nga mbështetja që gëzon ai nga një plejadë aktorësh publikë dhe privatë amerikanë.** Rrënjët e kësaj mbështetjeje amerikane janë të shumta, por përfshijnë publikun numerikisht të rëndësishëm të votuesve të krishterë dhe çifutë, të cilët besojnë në ideologjinë sioniste, rregulla thelbësisht të liruara për financim të fushatës, një lobi të fuqishëm pro-izraelit (CUFI, AIPAC, ALEC etj.), një anshmëri të matshme pro-izraelite në media, dhe një gjeografi zgjedhore kundër-mazhoritare dhe një terren institucional që u jep fuqi të konsiderueshme vetoje mbështetësve të Izraelit dhe e anon sistemin partiak drejt interesave të zonave më të pasura, më të bardha, më të vjetra dhe më rurale.[33]

Tanku izraelit i drejtuar nga deti në kampin e refugjatëve Esh-Shati në pjesën veriore të Rripit të Gazës, 16 nëntor , 2023 © Yonatan Sindel | Flash90.

32 Ky seksion është përshtatur me lejen nga Colin Powers, "Wages of Genocide: Prospects for Israel's War Economy." *Noira Research* 3 qershor, 2024.

33 Shih Miller (2023), Pappe (2024), Mearsheimer and Waltz (2007), Oklobdzija (2023), Rynhold (2023), Chomsky (2015), Herman and Chomsky (1988), Dunsky (2008), and Jackson (2023) në materialet shtesë për lexim.

Qeveria Federale dhe Ushtria e SHBA

Derdhjet e qeverisë federale në shtetin e Izraelit janë të konsiderueshme. Vitin e kaluar, SHBA shpenzoi 22.76 miliardë dollarë për ndihmën ushtarake, duke financuar afërsisht 70% të kostove të luftës së Izraelit.[34] Në terma relativë, granti standard vjetor i dërguar Izraelit nga programi i Financimit të Jashtëm Ushtarak i SHBA-ve (FMF) – 3.3 miliardë dollarë në vit që nga administrata e Obamës – zakonisht mbulon 15% të shpenzimeve të mbrojtjes të Izraelit. Këto grante paguhen nga të ardhurat e taksapaguesve amerikanë ose nga borxhet sovrane për t'u paguar përfundimisht nga taksapaguesit amerikanë. Me shpenzimet e luftës të Izraelit të buxhetuara për t'u rritur me afro 15 miliardë dollarë në vitin 2024, kjo linjë granti nga qeveria federale e SHBA u rrit në mënyrë dramatike. Akti i Sigurisë Kombëtare i vitit 2024, i nënshkruar në ligj në prill, drejtoi plot 13 miliardë dollarë në llogarinë bankare fitimprurëse të Izraelit në Rezervën Federale. Nga kjo shumë, 5.2 miliardë dollarë u caktuan për rimbushjen e sistemeve të raketave Iron Dome, Iron Beam dhe David's Sling; 4.4 miliardë dollarë për rimbushjen e rezervave të municioneve të varfëruara dhe 3.5 miliardë dollarë për sistemet e avancuara të armëve. **Për ta vënë këtë në perspektivë, Izraeli është deri tani përfituesi më i madh kumulativ i ndihmës amerikane në botë, e cila jepet me kushtet më bujare në botë**.[35] Stoku i armëve amerikane në Izrael, WRSA-I, është stoku më i madh amerikan jashtë shtetit i këtij lloji në botë.

Këto shpenzime shoqërojnë mobilizimin e konsiderueshëm të aseteve ushtarake dhe diplomatike të SHBA-ve për të nxitur gjenocidin e Gazës. Pentagoni vendos vazhdimisht aeroplanmbajtës, nëndetëse me energji bërthamore, flotë avionësh luftarakë dhe shkatërrues detarë në Mesdheun lindor për të mbrojtur Izraelin teksa e shkatërron Gazën.[36]

Pesëqind avionë transporti ushtarak amerikan dhe 107 anije i kanë dorëzuar Izraelit më shumë se 50.000 ton armatime dhe pajisje ushtarake në 10 muajt e parë të luftës, mesatarisht pothuajse dy dërgesa armësh në ditë.[37] Ushtria amerikane përdor avionët e saj gjuajtës-kapës të raketave THAAD për ta izoluar Izraelin nga sulmet rajonale që mund të pengojnë agresionin izraelit. Forcat speciale amerikane, oficerë të logjistikës, këshilltarë, spiunë dhe mercenarë të trajnuar nga CIA ndihmojnë operacionet luftarake izraelite. Diplomatët amerikanë vënë veton në mënyrë të përsëritur mbi rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSOKB) që kërkojnë një armëpushim; përpiqen t'i pushojnë nga puna zyrtarët e OKB-së për dokumentimin e krimeve izraelite; e gënjejnë Kongresin për politikat izraelite për vrasje përmes urisë [38] dhe minojnë përpjekjet e organeve ndërkombëtare si Gjykata Penale Ndërkombëtare për të mbajtur përgjegjëse qeverinë Netanyahu.[39]

Tregtia e armëve

Pa derdhjen e pamëshirshme të predhave të artilerisë, raketave dhe mbushjeve raketore të ofruara nga SHBA-të dhe Gjermania, fushatat aktuale në Gaza dhe Libanin Jugor do të ndaleshin me shpejtësi. Armët e përdorura për të vrarë palestinezët në Gaza janë armët amerikane: mitraloza amerikanë M16, bomba amerikane MK84 dhe MK82, avionë luftarakë amerikanë F-16, raketa amerikane zjarr-skëterrë, dronë amerikanë, fosfor i bardhë amerikan dhe artileri amerikane tankesh dhe predha mortajash. Ato shiten me fitim nga kompanitë amerikane të armëve si: Boeing, Lockheed Martin dhe General Dynamics dhe blihen me ndihmën e granteve të financimit të ushtrisë amerikane.

34 Linda J. Bilmes et al. "United States Spending on Israel's Military Operations, October 7, 2023 – September 30, 2024." *Costs of War Project* at Brown University, October 7, 2024.

35 Jonathan Masters and Will Merrow. "U.S. Aid to Israel in Four Charts." *Council on Foreign Relations*, November 13, 2024.

36 Schmitt, Eric. "Trying to Head Off War, U.S. Moves Naval Forces Closer to Israel." *The New York Times*, August 25, 2024.

37 Emanuel Fabian and ToI Staff. "Israel Says US Shipments of Arms and Equipment During War Exceed 50,000 Tons." *The Times of Israel*, August 26, 2024.

38 Murphy, Brett. "Israel Deliberately Blocked Humanitarian Aid to Gaza, Two Government Bodies Concluded. Antony Blinken Rejected Them." *ProPublica*, September 24, 2024.

39 Wong, Edward. "Blinken Meets With el-Sisi in Egypt to Discuss Plight of Palestinians in Gaza." *The New York Times*, January 11, 2024.

Shumë prej këtyre sistemeve të avancuara të raketave dhe armëve nuk mund të ndërveprojnë me zëvendësues rusë ose kinezë, duke kërkuar pjesë specifike amerikane për të funksionuar. Google Cloud, Amazon Web Services dhe Microsoft Azure gjithashtu i furnizojnë forcat dhe inteligjencën izraelite me "cloud-computing", mësimin e makinerive dhe shërbime të inteligjencës artificiale. Pa këto shërbime "cloud" dhe ndarjen e supozuar të të dhënave në WhatsApp, programet izraelite të vrasjeve masive të udhëhequra nga AI, Lavender dhe Gospel, do të shkatërroheshin.

Me fuqi punëtore dhe pjesë këmbimi të konsiderueshme amerikane, Izraeli gjithashtu prodhon armët dhe sistemet e veta të mbikëqyrjes, të cilat më pas testohen dhe përsosen në 'laboratorin' e territoreve të pushtuara palestineze.[40] Këto produkte, të tilla si teknologjia e mbikëqyrjes Pegasus e NSO ose dronët vrasës të Elbit-it shiten jashtë në mbi 130 vende, duke përftuar të ardhura dhe këmbim me valuta të huaja.[41] Për shembull, Izraeli furnizoi gati 70% të arsenalit të Azerbajxhanit midis viteve 2016 dhe 2020 dhe në heshtje ndihmoi Bakunë të shpopullonte Nagorno Karabahun nga të krishterët armenë në shtator 2023. Në këmbim, Azerbajxhani furnizon të paktën 40% të nevojave të Izraelit për naftë. India është blerësi më i madh dhe më i besueshëm i armëve në Izrael, të cilat Nju Delhi i përdor në pushtimin e vazhdueshëm të Kashmirit.[42] Izraeli gjithashtu i ka shitur armë juntës në Mianmar gjatë dhe pas gjenocidit të rohingia, si dhe Bangladeshit dhe Rusisë autokratike. Kompanitë izraelite si Black Cube operojnë gjithashtu globalisht, duke ndihmuar oligarkët dhe njerëzit e pasur për të mposhtur rastet e krimit të jakës së bardhë kundër tyre.[43] Këto kontrata përftojnë të ardhura për aparatin shtetëror izraelit dhe punësim për ish-oficerët e inteligjencës.

Qeveria shtetërore dhe lokale

Qeveria federale e SHBA-ve nuk është e vetmja në injektimin e financimit në arkat e shtetit klient. Qeveritë e shtetit, të qarkut dhe madje edhe ato komunale në të gjithë Shtetet e Bashkuara kanë hapin fletoren e çeqeve për Izraelin. Ky kanal financimi mbikëqyret nga Korporata e Zhvillimit për Izraelin (Development Corporation for Israel), një entitet i regjistruar në SHBA që vepron si ndërmjetës dhe agjenci lokale sigurimi për Ministrinë e Financave të Izraelit. Që nga viti 1951, Korporata e Zhvillimit për Izraelin ka emetuar ato që quhen "Obligacionet e Izraelit" brenda tregut amerikan. Këto instrumente borxhi, të cilat janë të shprehura në dollarë amerikanë dhe të përcaktuara për të ofruar mbështetje të përgjithshme buxhetore, zakonisht përfaqësojnë 12-15% të borxhit total të jashtëm të Izraelit. Si të tilla, ato përbëjnë një burim të konsiderueshëm kredie dhe valutë të fortë për shtetin e aparteidit. Të tunduar nga interesa të veçanta dhe kapja institucionale, institucionet publike lokale po investojnë shuma të konsiderueshme në sipërmarrjet gjenocidale të Izraelit, tani dhe në të ardhmen.

Protest për Embargo në Armatim në Massachusetts State House, gusht 2024.

40 Shih Antony Loewenstein, *The Palestine Laboratory*. 2023. Verso.

41 Freedman, Avidan. "How Israel's Supreme Court Rubber Stamps Arms Deals to Dictators." *Haaretz*, 16 korrik, 2023.

42 Essa, Azad. "India and Israel: The Arms Trade in Charts and Numbers." *Middle East Eye*, May 31, 2022.

43 Për shembull, Harvey Weinstein e autorizoi Black Cube t'i diskreditonte dhe pergjonte gratë që ai i përdhunoi.

Që nga 7 tetori 2023, Korporata e Zhvillimit për Izraelin ka rritur ndjeshëm shitjen e obligacioneve të Izraelit, pjesërisht duke thelluar partneritetet e saj me një organizatë lobuese të krahut të djathtë të quajtur Këshilli Amerikan i Shkëmbimit Legjislativ (American Legislative Exchange Council – ALEC). Për dy dekadat e fundit, ALEC ka qenë një forcë me ndikim prapa skenave në politikën amerikane. Në mënyrë tipike, ai harton projektligje mbi tema nga aborti deri te lëvizja Bojkot, Heqje e së Drejtës dhe Sanksione dhe më pas shpërndan shabllonet legjislative tek aleatët në dhomat shtetërore të qeverisë, ku ato miratohen në ligj. Duke u bashkuar për kauzën e Izraelit këtë vjeshtë, ALEC i zgjeroi operacionet e saj duke mobilizuar Fondacionin e Zyrtarëve Financiarë Shtetërorë (State Financial Officers Foundation) për të nxitur fondet publike të pensioneve dhe departamentet e thesarit shtetëror dhe bashkiak në blerjen e obligacioneve të Izraelit. Frytet e këtyre punëve janë befasuese: 1.7 miliardë dollarë blerje obligacionesh në vetëm gjashtë muaj.[44]

Shumë departamente të policisë lokale dhe shtetërore në SHBA shpenzojnë gjithashtu shuma të pallogaritshme të parave të taksapaguesve amerikanë në Izrael.[45] Mijëra oficerë policie, nga të paktën 12 shtete, duke përfshirë Massachusetts dhe zonat kryesore metropolitane (përfshirë departamentet policore në Boston, Cambridge, New York dhe Atlanta) kanë udhëtuar të gjithë në Izrael për trajnim. Në Izrael, policia amerikane merr udhëzime për mbikëqyrjen masive, profilizimin racor dhe shtypjen e protestave dhe pakënaqësisë.[46] Sipas fjalëve të ish-ushtarit të IDF, Eran Efrati, delegatët e policisë amerikane janë dëshmitarë të "demonstrimeve të drejtpërdrejta të dhunës represive në kohë reale, në protesta në të gjithë Bregun Perëndimor, patrullime në Jerusalemin Lindor dhe vizita të kufirit të Gazës".[47]

Që nga viti 2002, Lidhja Anti-Shpifje (Anti-Defamation League), Projekti Ndërkëmbim i Komitetit Çifut Amerikan (American Jewish Committee's Project Interchange) dhe Instituti Çifut për Çështjet e Sigurisë Kombëtare (Jewish Institute for National Security Affairs) kanë paguar trajnimin e shefave të policisë në Izrael dhe në territoret e pushtuara palestineze. **Vizitorë të tillë përfshijnë shefin e policisë së MIT, John Difava**. Departamentet e policisë amerikane, së bashku me CIA, FBI dhe ICE gjithashtu blejnë produkte vëzhgimi nga industria izraelite e armëve dhe shkëmbejnë informacione inteligjence mbi aktivistët.

Kapitali privat dhe teknologjia

Lufta e Izraelit ndaj Gazës dhe mirëmbajtja e ekonomisë së aparteidit mbështeten në përkrahjen e gjerë nga kapitali privat amerikan. Investitorët e kapitalit sipërmarrës të Tel Avivit mbledhin pothuajse të gjithë financimin e tyre (75-80%) në tregjet e kapitalit të Shteteve të Bashkuara.[48] Menjëherë pas pushtimit të Gazës, bankat amerikane rregulluan gjithashtu shitjet e obligacioneve private në emër të shtetit izraelit, të ardhurat e të cilave nuk bëhen publike. Në mars 2024, Bank of America dhe Goldman Sachs së bashku me Deutsche Bank dhe BNP Paribas vepruan si agjenci sigurimi për shitjen e parë ndërkombëtare të obligacioneve të Izraelit pas 7 tetorit. Këta financues inkurajuan nivelet e kërkesës së investitorëve nga e gjithë bota të mjaftueshme për ta bërë shitjen e bonove më të madhen në historinë izraelite: eurobono me vlerë 8 miliardë dollarë u shitën në një ditë të vetme.

44 Munira Lokhandwala and Molly Gott. "U.S. State and Local Treasuries Hold At Least $1.6 Billion in Israel Bonds." Little Sis Public Accountability Initiative, 5 shkurt, 2024.

45 "Deadly Exchange: The Dangerous Consequences of American Law Enforcement Trainings in Israel." *Researching the American-Israeli Alliance and Jewish Voice for Peace*, shtator 2018.

46 Garwood, Edith. "With Whom Are Many U.S. Police Departments Training? With a Chronic Human Rights Violator – Israel." *Amnesty International,* 25 gusht, 2016.

47 Gadzo, Mersiha. "How the US and Israel Exchange Tactics in Violence and Control." *Al Jazeera*, 12 qershor, 2020.

48 Israel Innovation Authority, "State of the High-Tech Industry in Israel 2023", Annual Report (Qershor 2023).

Firmat amerikane të teknologjisë fusin kapital të konsiderueshëm në Izrael në mes të angazhimit të shtetit në gjenocid. Gjatë vitit të kaluar, Nvidia, lideri global me bazë në Santa Clara (SHBA) në prodhimin e çipave dhe informatikës së inteligjencës artificiale, ka vjelur para të mëdha në blerjet e firmave izraelite. Në dhjetor, i bekuar nga një grant masiv prej 3.2 miliardë dollarësh dhe një normë e reduktuar shumë e taksave (7.5% në vend të 23%), Intel, punëdhënësi më i madh privat në Izrael, ra dakord të ndërtojë një fabrikë të re për gjysmëpërçuesit. Një muaj më vonë, Palantir Technologies, firma e shërbimeve softuerike e themeluar nga miliarderët e krahut të djathtë Peter Thiel dhe Alex Karp, njoftoi një partneritet të ri strategjik të AI me Ministrinë e Mbrojtjes të Izraelit për të "shfrytëzuar teknologjinë e avancuar të Palantir në mbështetje të misioneve të lidhura me luftën". Google dhe Amazon në mënyrë të ngjashme u ofrojnë forcave izraelite kapacitetin për të ruajtur, përpunuar dhe analizuar të dhëna, duke përfshirë njohjen e fytyrës, njohjen e emocioneve, biometrikën dhe të dhënat demografike në atë që njihet si Projekti Nimbus.

Shteti dhe ekonomia izraelite marrin gjithashtu mbështetje të konsiderueshme nga fondacionet filantropike amerikane, të cilat mbështeten dhe inkurajohen nga ligji i taksave në SHBA. Izraeli vazhdon të marrë mbi 3 miliardë dollarë çdo vit nga donatorët e huaj. Pjesa më e madhe e kësaj filantropie është amerikane.[49] Disa nga këto fonde janë derdhur në OJQ-të izraelite pro kolonëve si Regavim dhe Amana – transferime të cilat Departamenti i Thesarit i SHBA-së i lejon pavarësisht sanksioneve britanike dhe kanadeze. Shitjet e pasurive të paluajtshme të territoreve të pushtuara palestineze nganjëherë mbahen në sinagoga dhe kisha të përjashtuara nga taksat. Organizatat jofitimprurëse që mbështesin vendbanimet ilegale izraelite në Bregun Perëndimor dhe Jerusalemin Lindor të pushtuar gëzojnë statusin 501(c)(3) të përjashtimit nga taksat në Shtetet e Bashkuara dhe taksapaguesit amerikanë mund të përdorin donacionet e tyre për grupe të tilla si një fshirje e taksave.

Këto përfshijnë Agjencinë Çifute (Jewish Agency); Fondin Kombëtar Çifut (Jewish National Fund), HaYovel, AIEF, Miqtë e IDF dhe Fondacionin Ne'eman. Organizatat bamirëse dhe grupet e kampusit si Hillel, Birthright, StandWithUs dhe Chabad angazhohen në mbrojtjen e qartë të kolonëve dhe IDF-së me urdhër të qeverisë izraelite.[50] Pa këtë ekosistem filantropik, shteti i aparteidit do të përballej dukshëm me më shumë presion.

Roli i universiteteve

Universitetet kanë një rol të rëndësishëm në përfundimin e mbështetjes së SHBA-ve për Izraelin dhe rrjedhimisht vetë aparteidin izraelit. Kapitalizimi total i fondeve të universiteteve amerikane ishte rreth 840 miliardë dollarë në vitin fiskal 2023, duke i bërë ata investitorë të rëndësishëm institucionalë në ekonominë kapitaliste. Në raport me madhësinë e popullsisë së tij kombëtare, Izraeli dërgon një pjesë më të madhe të studiuesve të tij akademikë në Shtetet e Bashkuara se çdo vend tjetër,[51] kurse qeveria izraelite dhe institucionet akademike gëzojnë bashkëpunime të thella dhe prestigjioze me universitetet amerikane.[52] Universitetet janë gjithashtu organizata të respektuara dhe unike. Me fjalët e Eaton dhe Stevens (2020), ato kanë *pozicion qendror* në rendin institucional të shoqërive moderne që ofrojnë "lidhje pune midis shtetit, tregut, shoqërisë civile dhe organizatave të sferës private", si dhe janë *gjoja-sovrane*, duke gëzuar një margjinë të juridiksionit mbi punët e tyre të brendshme. Universitetet amerikane e kanë përdorur këtë thuajse sovranitet për të përfituar nga gjenocidi dhe për të bashkëpunuar me vetë qeverinë izraelite.

49 Shih Fleisch, Eric. 2024. *Checkbook Zionism: Philanthropy and Power in the Israel-Diaspora Relationship.* Rutgers University Press.

50 Lee Fang and Jack Poulson. "Israeli documents show expansive government effort to shape US discourse around Gaza war," *The Guardian*, 24 qershor 2024.

51 Dattel, Lior. «Israel Is No. 1 Exporter of Academic Talent to the U.S., Data Shows,» *Haaretz*, 28 janar, 2019.

52 Shih Wind, Maya. 2024. *Towers of Ivory and Steel: How Israeli Universities Deny Palestinian Freedom.* Verso Books.

Kjo është një zgjedhje institucionale dhe mund të rikthehet. Në Irlandë, Spanjë, Belgjikë, Finlandë dhe Norvegji, disa universitete tashmë janë zotuar të distancohen nga pushtimi izraelit. Më 9 maj 2024, Konferenca e Rektorëve të Universiteteve në Spanjë (CRUE) që përfaqëson 76 universitete publike dhe private në Spanjë njoftoi synimin e tyre për të "pezulluar marrëveshjet e bashkëpunimit me universitetet dhe qendrat kërkimore izraelite që nuk kanë shprehur një angazhim të vendosur për paqen dhe pajtimin me të drejtën ndërkombëtare humanitare" si dhe synimin e saj për të "forcuar bashkëpunimin me sistemin shkencor dhe të arsimit të lartë palestinez".

Në Norvegji, pesë universitete pezulluan lidhjet me universitetet izraelite deri në shkurt të vitit 2024, siç bëri edhe Universiteti i Helsinkit, si universitet flamurtar i Finlandës. Më 8 maj, Kolegji Trinity i Irlandës në Dublin arriti një marrëveshje me studentët për "t'u larguar nga kompanitë izraelite që kanë aktivitete në Territorin e Pushtuar Palestinez" dhe për të krijuar një Fond Shenjtëror për studiuesit e Gazës. Këto angazhime nuk kufizohen vetëm në Evropë; Seminari Teologjik i Unionit dhe Kolegji Shtetëror Evergreen në SHBA kanë njoftuar gjithashtu vendime për të mbështetur jetën palestineze.

Megjithatë, siç ilustrohet nga MIT, shumica e institucioneve amerikane të arsimit të lartë janë bashkëfajtorë me regjimin e aparteidit izraelit, pavarësisht se në mënyrë hipokrite përkrahin angazhimet publike për barazinë, etikën shkencore, mendimin kritik dhe lulëzimin njerëzor. Këto kontradikta mund të sfidohen nga studentët që nuk gëzojnë një fuqi të tillë unike në fusha të tjera. Lufta kundër regjimeve shtypëse është një luftë kundër legjitimitetit të tyre popullor, si dhe ndaj mundësive të tyre materiale. Studentët, si një shtresë e re dhe e arsimuar, i dërgojnë botës një sinjal të rëndësishëm për atë që konsiderohet e tolerueshme.

Për shembull, në maj të vitit 1970, aktivistët e MIT e shtynë Institutin të pranonte shqetësimet serioze për bashkëpunimin e tij në mizoritë e kryera nga forcat amerikane në Vietnam dhe u larguan nga qendra e tij speciale kërkimore, Laboratori Charles Stark Draper, i cili punonte në sistemet udhëzuese për raketat Poseidon. [53] Lëvizjet studentore amerikane në vitet 1980 ishin vendimtare në fushatat e distancimit nga aparteidi i Afrikës së Jugut dhe ngjallën vullnet politik për sanksione. Deri në vitin 1984, 53 universitete ishin distancuar pjesërisht nga aparteidi, dy vjet përpara se Kongresi të votonte për të anuluar veton e presidentit Ronald Reagan dhe për të miratuar Aktin Gjithëpërfshirës Anti-Aparteid (Comprehensive Anti-Apartheid Act) të vitit 1986.

Aktivistët studentorë janë rebeluar kundër padrejtësive edhe më parë; ata ishin në qendër të opozitës ndaj luftërave të Vietnamit, Irakut dhe Afganistanit, Jim Crow dhe kapitalit të karburanteve fosile. Duke vepruar së bashku për të qëndruar në solidaritet me palestinezët të palëkundur kundër aparteidit dhe kolonializmit të kolonëve, studentët mund të bëhen lëvizësit e parë në kontekstin kombëtar, duke dërguar një mesazh se sionizmi ka humbur një brez. Gjatë 20 viteve të fundit, studentët kanë sfiduar politikbërësit që "arritën me vonesë në qëndrime mbi pabarazinë ekonomike, ndryshimet klimatike, politikën e drogës dhe drejtësinë penale që radikalët e supozuar në kampus i morën shumë përpara tyre".[54] Duke shënuar fitore ndaj MIT dhe institucioneve të tjera, studentët mund të shkaktojnë kështu një kaskadë vendimesh të ngjashme institucionale që veprojnë për ta izoluar dhe paralizuar regjimin izraelit të aparteidit. Siç tha një herë Eqbal Ahmed: "detyra kryesore e luftës revolucionare është të arrijë izolimin moral të kundërshtarit në sytë e tij dhe në sytë e botës". Ose me fjalët e ish-aktivistit studentor të MIT, Mike Albert më 1969: "Për ne në MIT, detyra është e qartë. Ne duhet të rrisim çmimin e luftës derisa zotëruesit e saj t'i japin fund asaj".

53 Hevesi, Dennis «Howard W. Johnson, President of M.I.T. During Vietnam War Protests, Dies at 88.» *The New York Times*, 18 dhjetor, 2009.

54 Nwanevu, Osita «US Students, Once Again, Have Led the Way. Now We Must All Stand Up for Palestinians,» *The Guardian*, 13 maj, 2024.



Seksioni 2:

Kërkimi shkencor i MIT për Gjenocid

Kërkimi shkencor i MIT për Gjenocid

Sulmet ajrore izraelite duke goditur Qytetin e Gazës, 8 tetor, 2023 (Fatima Shbai | AP Photo)

Ministria e Mbrojtjes e Izraelit (ID e sponsorit #001134) ka sponsorizuar mbi 3.7 milionë dollarë në projektet kërkimore të MIT që nga viti 2015. [55] Megjithatë, sponsorizimi shkon prapa të paktën deri në vitin 2008. Shuma e parave është e vogël – sponsorizimi i ndarë nga Ministria e Mbrojtjes e Izraelit **përbën vetëm 0,05% të sponsorizimit të kërkimit të MIT-it për vitin 2024. Në secilin prej laboratorëve të sponsorizuar aktualisht, këto grante përbëjnë mesatarisht vetëm 2% të buxhetit total, i cili përfshin burime të tjera financimi për shumë projekte pothuajse identike. Kjo është një çështje e parimeve të MIT; Izraeli është e vetmja ushtri e huaj që sponsorizon kërkimet e MIT-it.**[56]

Këto fonde mbështesin projekte me zbatime ushtarake. Disa projekte krijojnë algoritme ideale për të mësuar mjetet e vogla pa pilot, duke përfshirë dronët, që të ndjekin caqet me autonomi të shtuar. Të tjerë përmirësojnë mbikëqyrjen nënujore ose ndihmojnë avionët ushtarakë të shmangin dhe zbulojnë raketat. Laboratorët e implikuar të MIT përfshijnë Laboratorin për Sistemet e Informacionit dhe Vendimit (Laboratory for Information & Decision Systems – LIDS), Laboratorin e Shkencave Kompjuterike dhe Inteligjencës Artificiale (Computer Science and Artificial Intelligence Laboratory – CSAIL) dhe Laboratorin Kërkimor të Elektronikës (Research Laboratory of Electronics – RLE).

55 Për një përmbledhje fletëllogaritëse të sposorizimit shkencor të MIT nga Ministria e Mbrojtjes e Izraelit, shih tinyurl.com/mitimod-sponsorship

56 Të vetmit sponsorë të tjerë që mund të interpretohen si ushtarakë të huaj janë Laboratorët Kombëtarë të DSO të Singaporit (ID-ja e sponsorit #005831) dhe Agjencia e Shkencës dhe Teknologjisë së Mbrojtjes së Singaporit (ID-ja e sponsorit #001100) dhe Grupi i Shkencës dhe Teknologjisë i Mbrojtjes i Departamentit të Mbrojtjes i Australisë. Megjithatë, të trijat janë kompani teknikisht private, puna e të cilave mbështet kryesisht ushtrinë e Singaporit dhe Australisë, përkatësisht.



2.1 Si vepron Sponsorizimi kërkimor i MIT

Kërkimi i sponsorizuar në MIT është kërkim i sponsorizuar ose financuar nga një organizatë e jashtme. Zakonisht kryhet nga trupi pedagogjik i MIT dhe hetuesit kryesorë (PI) në laboratorët dhe grupet e tyre kërkimore. Ai vjen në tri lloje të ndryshme: grante federale, kontrata federale dhe marrëveshje jo-federale. Nëpërmjet sponsorizimit, subjektet e huaj si Ministria e Mbrojtjes e Izraelit (IMoD) kanë të drejtën e deklaruar për të "trajtësuar drejtimin dhe objektivat" e kërkimit, si dhe "të drejtat për t'i përdorur rezultatet e kërkimit". Marrëveshjet jo-federale dhe grantet federale janë kategoritë që përfshijnë kërkimet e sponsorizuara nga IMoD. Laboratorët e MIT hyjnë në një marrëveshje jo-federale me industri, agjenci ose ministri të huaja si IMoD dhe institucione të tjera kërkimore jofitimprurëse. Fondet përdoren për të siguruar pajisje dhe burime llogaritëse për projekte aktive, si dhe buxhetin e udhëtimit dhe të ardhurat për kërkuesit si post-doktorantë, punonjës të diplomuar ose PI.

Projektet kërkimore ndajnë rrjete komplekse, të mbivendosura të financimit dhe një projekt mund të përfshijë agjenci të shumta të lidhura me ushtrinë. Për shembull, hulumtimi i MIT mbi Magnetometrinë e Fibrave Kuantike, i vendosur në Laboratorin Kërkimor të Elektronikës (RLE) të MIT-së, sponsorizohet nga forcat ajrore të SHBA, ushtria amerikane dhe Fondacioni Kombëtar i Shkencës, si dhe nga IMoD. Këto burime financimi janë pranuar në mënyrë jokonsistente në publikimet ose rezultatet e projekteve kërkimore. Për këtë arsye, ekipi kërkimor i Të Diplomuarve të MIT për Palestinën mblodhi për herë të parë informacion mbi projektet e IMoD në vjeshtën e vitit 2023 nga Kuali Coeus, një sistem i brendshëm i menaxhimit të çmimeve të përjetshme i disponueshëm për bashkëpunëtorët e MIT që gjurmon informacionin e sponsorizimit të kërkimit. Megjithatë, qasja e përgjithshme në këtë ishte i kufizuar pasi Koalicioni Kundër Aparteidit (CAA) publikoi këto gjetje.

Informacioni në lidhje me mbështetjen e IMoD mund të gjendet gjithashtu në shtojcat 'Brown Books' të MIT, të cilat janë në dispozicion FY2015-2023 dhe ofrojnë sponsorin, ID-të e projektit, emrat e PI-ve, shumën totale të autorizuar dhe shumën totale të shpenzuar për projektet në vitin e caktuar. Më tej në kohë janë Raportet e Auditit Udhëzues Uniform (A-133) për VF 2006-2022, të cilat janë të disponueshme për publikun. Në këta skedarë, Ministria e Mbrojtjes së Izraelit (ID-ja e sponsorit #001134) në përgjithësi renditet si sponsor direkt ose thjesht "sponsor" me Departamentin e Mbrojtjes së SHBA-ve (DoD) ose Agjencinë e Projekteve të Avancuara të Kërkimit të Mbrojtjes (Defense Advanced Research Projects Agency – DARPA) të listuara si sponsori parësor ose kryesor. Për hetuesit kryesorë Paul Lagace dhe David Simchi-Levi, IMoD renditet si sponsor direkt dhe parësor. Siç përcaktohet në fjalorin e termave nga Brown Book 2023, sponsori parësor/kryesor është "entiteti origjinal që ofron fonde për një kërkim të sponsorizuar" ndërsa sponsori i drejtpërdrejtë është sinonim në disa skedarë të Institutit si entiteti i përafërt, "kalimtar".

> Me fjalë të tjera, projektet e MIT marrin një çmim nga Ministria e Mbrojtjes e Izraelit (sponsor i drejtpërdrejtë) i cili vetë financohet nga Departamenti i Mbrojtjes (sponsor parësor).

Ky formë qarkore thekson se si financimi federal i SHBA-së për qeverinë izraelite kthehet në MIT për përfitimin përfundimtar të pushtimit izraelit. Departamenti Amerikan i Mbrojtjes i ofron qeverisë izraelite grante të huaja financimi ushtarake dhe siguron sponsorizimet e saj në universitetet amerikane si MIT. Nga ana e saj, ministria izraelite zgjedh se cilat projekte do të sponsorizojë, ose përdor fondet e DoD për të mbështetur studentët izraelitë të doktoraturës për t'u bashkuar me laboratorët e MIT për projekte specifike me interes për objektivat e tyre kërkimore ushtarake. Fondet ende vijnë më së shumti nga qeveria izraelite si sponsor direkt. Në Kuali Coeus, IMoD renditet si emri i sponsorit për këto projekte, në krahasim me Departamentin e Mbrojtjes, dhe lloji përkatës i sponsorit renditet si "Qeveria Federale e Huaj". IMoD më pas përfiton nga qasja në rezultatet e kërkimit si sponsor. Mund të jetë e mundur që MIT ose Departamenti i Mbrojtjes të riplanifikojnë kanalin e financimit nën një ministri tjetër të qeverisë izraelite, siç është ministria e energjisë. Megjithatë, kjo do të shmangte problemin e llogaridhënies. Kjo do të kontribuonte ende në ngritjen e reputacionit të qeverisë izraelite.

Për shembull, MIT në vitin 2019 kërkoi falje publike për ngritjen e reputacionit të abuzuesit seksual të fëmijëve Jeffrey Epstein kur fakulteti dhe laboratorët e tij pranuan donacione nga Epstein. Lidhjet kërkimore të MIT me qeverinë izraelite kontribuojnë në mënyrë të ngjashme në ngritjen e reputacionit të kësaj të fundit pavarësisht nga krimet e vazhdueshme kundër njerëzimit. MIT aktualisht vendos projektet e financuara nga njerëz ose subjekte në Arabinë Saudite, Kinë dhe Rusi nën një rishikim të rrezikut të lartë, pjesërisht për shkak të shqetësimeve se projekte të tilla mund të "legjitimojnë në mënyrë indirekte shkeljet e të drejtave politike, njerëzore ose civile në atë vend" ose "do të përdoren në mënyra që do të cenonin të drejtat politike, njerëzore ose civile në një vend të huaj." Pse duhet MIT të angazhohet në sponsorizime kërkimore me qeverinë izraelite, duke pasur parasysh shkallën e abuzimeve të të drejtave të njeriut në Palestinë?

2.2: Financimi Ushtarak Izraelit nga Laboratori

Tabela e mëposhtme ofron një përmbledhje të financimit të IMoD të shpenzuar dhe të ndarë nga hetuesi kryesor (PI), departamenti dhe projekti.

Hetuesi kryesor	Departamenti	Titulli i projektit	Shpenzimet e përgjithshme (2015-2024)
Qing Hu	EECS, RLE	Lazerë Teraherc kuantikë-kaskadë dhe imazhe (Terahertz Quantum-Cascade Lasers and Imaging)	$ 430.000
Sertac Karaman	LIDS	Algoritmet e planifikimit dhe ndjimit për monitorimin e qëndrueshëm nënujor (Planning and Sensing Algorithms for Underwater Persistent Monitoring)	$ 299.700
Yoel Fink	RLE	Sistemi i ri i fibrave multimateriale për zbulimin e valëve magnetike (Novel multimaterial fiber system for magnetic wave detection)	$ 430.355
Yoel Fink	RLE	Sistemi multifunksional i fibrave për ndjerjen e valëve magnetike (Multifunctional Fiber System for Magnetic Wave Sensing)	$ (16.731)
Emilio Frazzoli	LIDS	Eksplorimi i shpejtë i pemëve të rastësishme për lojëra ndjekje-shmangie (Rapidly Exploring Random Trees for Pursuit-Evasion Games)	$ 359.667
Paul A Lagace	Aero/Astro	[Pa Njoftim]	$ 80.571
Sertac Karaman	LIDS	Sisteme heterogjene me shumë agjentë për zbatime detare (Heterogenoeous Multi-Agent Systems for Maritime Applications)	$ 241.424
Christopher A. Voigt	BE	Efektet e mjediseve oksiduese në materialet me bazë karboni (Effects of Oxidizing Environments on Carbon-Based Materials)	$ 786.998
Christopher A. Voigt	BE	Biosensorë bakterialë të aftë për terren (Field-Capable Bacterial Biosensors)	$ 89.447
Sertac Karaman	LIDS	Algoritmet e planifikimit dhe kontrollit për ankorim autonome nënujore duke përdorur grafikë të rrallë dhe llogaritje të ngjeshur (Planning and Control Algorithms for Autonomous Underwater Docking using Sparse Graphs and Compressed Computation)	$ 269.543
Daniela Rus	EECS	Algoritmet ngjeshjeje pikash (Coreset Compression Algorithms)	$ 296.546
William D Oliver	Physics, RLE, EECS	Kubite me besueshmëri të lartë dhe leximi: Një bashkëpunim i propozuar midis MIT dhe HUJIO (High-Fidelity Qubits and Readout: A proposed Collaboration between MIT and HUJIO)	$ 239.806
Eytan Modiano	LIDS	Tufa autonome robotike: Koordinimi dhe perceptimi i shpërndarë (Autonomous Robotic Swarms: Distributed Coordination and Perception)	$ 137.147

Si shembull, hyrjet nga viti 2024 janë renditur në tabelën e mëposhtme me informacion më të detajuar. Siç shihet, vetëm një pjesë e buxhetit kumulativ për këto projekte (treguar në kolonën "Auth Total"), që aktualisht qëndron në 2.2 milionë dollarë, shpenzohet çdo vit, me shpenzimet e listuara në kolonën "Shuma VFDS":

Tabela 2: Sponsorizimi i kërkimit nga Ministria e Mbrojtjes e Izraelit në 2024

Sponsori parësor	Sponsorët e drejtpërdrejtë	Mbikëqyrës	WBS e Projektit	Skadimi i WBS të Projektit	Shuma e VFDS	Totali Auth	Bilanci i papritur	WBS Emri i Prijektit	Departamenti
000190 Departamenti i Mbrojtjes - Të ndryshme	001134 Ministria e Mbrojtjes e Izraelit	Fink /Yoel	11/16/18	06/30/20	$ (89.462,00)	$ 150.000,00	$ -	Sistemi multifunksional i fibrave për ndjerjen e valëve magnetike	RLE
		Karaman / Sertac	02/01/20	01/31/23	$ 31.610,00	$ 241.424,00	$ -	Sisteme heterogjene me shumë agjentë për zbatime detare	LIDS
		Voigt/ Christopher A.	02/01/20	03/31/24	$ (76.396,00)	$ 500.000,00	$ -	Efektet e mjediseve oksiduese në materialet me bazë karboni	BE
		Voigt/ Christopher A.	04/01/22	03/31/24	$ 289.909,00	$ 290.000,00	$ -	Efektet e mjediseve oksiduese në materialet me bazë karboni	BE
		Voigt/ Christopher A.	01/01/24	03/31/25	$ 89.447,00	$ -	$ (89.447,00)	Biosensorë bakterialë të aftë për terren	BE

Tabela 2: Sponsorizimi i kërkimit nga Ministria e Mbrojtjes e Izraelit në 2024 (vazhdim)

Sponsori parësor	Sponsorët e drejtpërdrejtë	Mbikëqyrës	WBS e Projektit	Skadimi i WBS të Projektit	Shuma e VFDS	Totali Auth	Bilanci i papritur	WBS Emri i Prijektit	Departamenti
000191 DOD - Të ndryshme - Jo të përbashkëta	001134 Ministria e Mbrojtjes e Izraelit	Rus / Daniela L	07/27/20	12/01/24	$ 121.072,00	$ 425,000.00	$ 128.454,00	Algoritme ngjeshjeje pikash	EECS
		Karaman/ Sertac	02/01/21	01/31/23	$ 16.782,00	$ 169,543.00	$ -	Algoritmet e planifikimit dhe kontrollit për lidhjen autonome nënujore duke përdorur grafikë të rrallë dhe llogaritje të ngjeshur	LIDS
		Fink /Yoel	07/01/19	12/31/21	$ 9.501,00	$ 81,437.00	$ -	Sistemi i ri i fibrave multimateriale për zbulimin e valëve magnetike	RLE
		Modiano/ Eytan H	01/16/22	06/30/25	$ 82.035,00	$ 240,000.00	$ 102.853,00	Tufa autonome robotike: Koordinimi dhe perceptimi i shpërndarë	LIDS
		Oliver/ William D	02/01/22	01/31/23	$ 107,00 $	119.806,00	$ -	Kubite me besueshmëri të lartë dhe leximi: Një bashkëpunim i propozuar midis MIT dhe HUJIO	Physics, RLE, EECS

10 PI-të e implikuar shpërndahen në gjashtë departamente: Inxhinieri Elektrike dhe Shkenca Kompjuterike, Fizikë, Aeronautikë dhe Astronautikë, Inxhinieri Biologjike, Shkencë dhe Inxhinieri Materiale (DMSE) dhe Inxhinieri Civile dhe Mjedisore. Laboratorët dhe qendrat përfshijnë Laboratorin Kërkimor të Elektronikës (RLE), Laboratorin për Sistemet e Informacionit dhe Vendimit (LIDS) dhe Laboratorin e Shkencave Kompjuterike dhe Inteligjencës Artificiale (CSAIL).

Seksioni 2.3: Kush përfiton?

Këto projekte kanë zbatime të dukshme ushtarake. LIDS dhe disa kërkime të EECS fokusohen shumë në tufat e mjeteve ajrore pa pilot. Projekti i Eytan Modiano dhe Sertac Karaman "WiSwarm" (i konfirmuar aktiv: 2022-2023 dhe i rinovuar së fundmi) ofron një protokoll për rrjetet pa tel që përfshin shumë fluturake pa pilot (UAV) që komunikojnë me një kompjuter "qendror" në mënyrë që ta koordinojnë lëvizjen kolektive dhe të mos i ngatërrojnë sinjalet. Projekti i Karaman përqendrohet në ndjekjen e objektivit me informacionin e dhënë nga "vërshëllima" nga sensorë me bazë tokësore në mënyrë që të përmirësohen këto ndjekje pa ndërhyrjen njerëzore. Projekti i Karaman për të zhvilluar Algoritme për monitorimin e përhershëm nënujor dhe ankorime autonome nënujore (i konfirmuar aktiv: 2013-2023) janë të dobishëm në kontrollimin e bllokadës detare të Gazës dhe monitorimin e bllokimit urban.

Kërkimi i Daniela Rus përqendrohet në koordinimin e tufës në prani të objektivave në lëvizje, veçanërisht atyre njerëzore. "Mbikëqyrja" citohet si zbatim. Projekti i saj "Algoritme ngjeshjeje pikash" zhvillon algoritme të AI për aplikacione si "sistemet e vëzhgimit në shkallë qyteti". Projektet e kaluara kanë sugjeruar aplikime për "mbikëqyrje dhe vigjilencë". Këto algoritme të lehta janë ideale për të mësuar mjetet e vogla pa pilot, duke përfshirë dronët, t'i gjurmojnë dhe ndjekin objektivat me autonomi të shtuar. Zbatimet ushtarake për këto teknologji përfshijnë bombardimet me dronë, vëzhgimin e protestave, ndjekjen e objektivave që shmangen dhe përdorimin e gazit lotsjellës gjatë prishjes së shtëpive.

Ushtria izraelite ka përdorur "trupa" të tilla avionësh dronë të armatosur për të gjuajtur objektivat në ikje në Gaza dhe për sulme të drejtpërdrejta ajrore.[57] Grumbuj kuadrokopterësh të armatosur izraelitë nxjerrin njerëzit nga shtëpitë e tyre duke emetuar tinguj të grave dhe fëmijëve në vuajtje dhe më pas i qëllojnë.[58]

Puna e RLE, Inxhinierisë Biologjike dhe Fizikës në MIT kontribuojnë gjithashtu në dhunën izraelite. Projekti i Lazerëve teraherc kuantikë-kaskadë dhe imazheve i Qing Hu (i konfirmuar aktiv: 2013-2018) përdor lazerë me bazë gjysmëpërçuese si një burim drite për sistemet e imazhit në kohë reale. Përdorimet e tij të mundshme përfshijnë sisteme anti-raketë të quajtura DIRCM për të ndihmuar avionët të shmangin raketat, si dhe imazhet e radarëve dhe skanimin në thellësi. Vetë kontraktuesit e mbrojtjes të Izraelit përfitojnë nga hulumtimi i DIRCM. Projekti i William Oliver, "Kubite me besueshmëri të lartë dhe leximi" zhvillon llogaritjen kuantike për aplikacionet algoritmike. Rastet e përdorimit ushtarak përfshijnë ndjimin me mikrovalë dhe fiksimin e saktë për navigimin e mohuar nga GPS. Në të vërtetë, llogaritja kuantike është një industri që kompleksi industrial ushtarak izraelit dëshiron ta zhvillojë. Yoel Fink punon në zbulimin e fushave të radiofrekuencës bazuar në fibra optike të përdorura për monitorimin e radios, mbikëqyrjen, zbulimin dhe luftën elektronike. Christopher Voigt zhvillon biosensorë si raportues hiperspektralë për zbulimin e kushteve mjedisore. Rastet e përdorimit ushtarak përfshijnë parashikimin e korrozionit në automjetet ushtarake, objektivat e mbikëqyrjes, zbulimin e kërcënimeve biologjike si dhe minat e groposura.

57 Gross, Judah Ari. "In Apparent World First, IDF Deployed Drone Swarms in Gaza Fighting," *The Times of Israel*, 10 korrik, 2021.

58 Hussaini, Maha. "War on Gaza: Israeli Drones Lure Palestinians with Crying Children Recordings Then Shoot Them," *Middle East Eye*, 17 prill, 2024.

Kujt i shërben ky hulumtim? Zyrtarët e MIT si Rektori dhe Kancelari thonë se projekte të tilla nuk janë të klasifikuara – se ato janë "kërkime themelore" dhe lirisht të disponueshme për hetuesit kudo dhe jo në një vend të caktuar. Megjithatë, kjo fsheh faktin se kërkimet e porositura nga ushtria tentojnë të mbështesin objektiva të veçanta ushtarake. Studiuesit kanë dokumentuar në mënyrë shteruese se si kërkimet akademike të sponsorizuara nga industria tentojnë të bëjnë që **akademizmi të anoj**ë në favor të duhanit, produkteve farmaceutike, sheqerit, plumbit dhe lëndëve djegëse fosile.[59] E njëjta gjë vlen edhe për ushtrinë. Në Palestinë, pushtimi izraelit teston në mënyrë rutinë teknologji të reja mbi civilët në "laboratorin" në Gaza, duke prodhuar etiketën "e testuar në betejë".[60] Duke sponsorizuar hulumtimin luftarak në këto teknologji, ushtria izraelite përfiton nga lidhja e saj me MIT. Lidhjet me MIT ndihmojnë gjithashtu ushtrinë izraelite të pastrojë reputacionin e saj, ngjashëm me mënyrën se si abuzuesi seksual Jeffrey Epstein përdori MIT-in për të pastruar imazhin e tij.[61]

Të ballafaquar me këto të vërteta të pakëndshme, shkencëtarët ndonjëherë e mashtrojnë veten duke besuar se kërkimi i tyre është moralisht neutral. "Ajo që unë po projektoj një ditë mund të përdoret për të vrarë miliona njerëz", i tha një punonjës i diplomuar MIT-it një gazetari në vitin 1969 gjatë bombardimeve të SHBA-ve të Vietnamit. "Nuk më intereson. Kjo nuk është përgjegjësia ime. Më është dhënë një problem interesant teknologjik dhe kënaqem duke kërkuar zgjidhjen e tij".[62] Megjithatë, një shkencëtar etik dhe një institucion etik ndjekin rrugë shkencore që afirmojnë jetën, që ndihmojnë të rregullohet bota dhe që refuzojnë të lejojnë që ushtritë abuzive ta pastrojnë reputacionin e tyre ndërkohë që kryejnë vrasje masive.

Si shkencëtarë kundër aparteidit, Koalicioni i MIT për Palestinën nuk do të ndihmojë ushtritë që gjymtojnë fëmijët, as dronët që godasin spitalet, as bombat që asgjësojnë qytetet. Ne luftojmë kundër sistemeve që, sipas fjalëve të Audre Lorde, orkestrojnë krizë pas krize dhe e shndërrojnë të gjithë të ardhmen tonë në pluhur. Ne qëndrojmë në solidaritet me të mjerët e Tokës. Ne refuzojmë t'ia kushtojmë punën tonë gjenocidit. Edhe MIT duhet ta bëjë këtë gjithashtu.

Si shkencëtarë kundër aparteidit, Koalicioni i MIT për Palestinën nuk do të ndihmojë ushtritë që gjymtojnë fëmijët, as dronët që godasin spitalet, as bombat që asgjësojnë qytetet. Ne luftojmë kundër sistemeve që, sipas fjalëve të Audre Lorde, orkestrojnë krizë pas krize dhe e shndërrojnë të gjithë të ardhmen tonë në pluhur. Ne qëndrojmë në solidaritet me të mjerët e Tokës. Ne refuzojmë t'ia kushtojmë punën tonë gjenocidit. Edhe MIT duhet ta bëjë këtë gjithashtu.

59 Sofia Hiltner et al., "Fossil Fuel Industry Influence in Higher Education: A Review and a Research Agenda," *Wire's Climate Change*, 5 shtator, 2024.

60 Shih Antony Loewenstein, *The Palestine Laboratory* (Verso: 2023).

61 North, Anna. "Jeffrey Epstein Used MIT to Launder His Image. It's a Lesson for the #MeToo Era," *Vox*, 9 shtator, 2019.

62 Shih Leslie, Stuart W. *The Cold War and American Science: The Military-industrial-academic Complex at MIT and Stanford.* United Kingdom: Columbia University Press, 1993.

Seksioni 3:

Bashkëpunimet e MIT me kontraktuesit ushtarakë izraelitë

Goditjet izraelite të Qytetit të Gazës, 11 tetor, 2023. © Saleh Salem | Reuters

Seksioni 3:
Bashkëpunimet e MIT me kontraktuesit ushtarakë izraelitë

Vendi i MIT-it **në kompleksin** ushtarako-industrial të SHBA-ve është i dokumentuar në mënyrë shteruese.[63] Partnerët tradicionalë përfshijnë RTX (Raytheon), Draper Laboratory, BAE Systems, Northrop Grumman dhe Boeing. Mesatarisht, rreth 60% e të ardhurave të MIT vijnë nga qeveria federale dhe 17.4% nga Departamenti i Mbrojtjes. MIT gjithashtu u jep përparësi bashkëpunimeve institucionale me firmat që shesin dhe transportojnë armë në Izrael për fitim. Këto bashkëpunime e legjitimojnë abuzimin e të drejtave politike, njerëzore dhe civile në Palestinë. Ata gjithashtu rekrutojnë trupin pedagogjik dhe studentë të MIT-it në aktivitete militariste dhe i anojnë agjendat kërkimore shkencore drejt zbatimeve ndërluftuese **në vend të** zbatimeve që vlerësojnë jetën. Më poshtë është një listë jo shteruese e kontraktuesve **të tillë ushtarakë izraelitë, të cilët Koalicioni për Palestinën** i MIT i ka gjetur veçanërisht të tmerrshëm në thellësinë e mbështetjes së tyre për aparteidin izraelit dhe kolonializmin e ardhacakëve.



Duke protestuar në Lobin 7 më 1971 (MIT Museum)

Elbit Systems

Elbit Systems, Ltd. është kontraktuesi më i madh ushtarak i Izraelit. Elbit furnizon 85% të arsenalit të dronëve vrasës të Izraelit dhe është një ofrues kryesor i municioneve mortajash, luftës elektronike, teknologjisë së inteligjencës sinjalizuese, fosforit të bardhë, bombave thërrmuese dhe predhave me gjilpëra për shtetin kolon të aparteidit. Dronët Elbit Hermes 450 u përdorën në masakrën e Kuzhinës Qendrore Botërore (World Central Kitchen) më 2024 në Gaza dhe vrasjen e 164 fëmijëve palestinezë në Gaza në vitin 2014.

63 Shih Leslie (1993), Nelkin (2019), dhe dokumentarin MIT: REGRESSIONS (63 2022).

Forcat e armatosura izraelite vazhdojnë të mbështeten sistematikisht në makinerinë Elbit për të kryer masakra (shih Gjenocidin e Gazës) dhe për t'i survejuar palestinezët e veçuar në Jerusalemin Lindor të pushtuar dhe Bregun Perëndimor. Elbit gjithashtu nxit shtypjen globalisht. Për shembull, Elbit i shet raketa Azerbajxhanit për t'i përdorur në spastrimin etnik të të krishterëve armenë nga Artsakh. Elbit furnizon ushtrinë e Indisë me dronë për t'u përdorur në pushtimin e Kashmirit, si dhe spyware për qeverinë etiopiane për të arrestuar disidentët. Ajo prodhon teknologji vëzhgimi për kufijtë SHBA-Meksikë dhe BE-Afrikë.

Pavarësisht provave të shumta të mbështetjes së drejtpërdrejtë materiale për shkeljen e të drejtave të njeriut, Elbit ka qenë anëtar i Programit të Ndërlidhjes Industriale të MIT (Induatrial Liason Program – ILP) që nga viti 2017. Përmes ILP, Elbit është në gjendje të monitorojë zhvillimet kërkimore të MIT, të identifikojë burimet me interes të MIT, të rregullojë takime ballë për ballë me trupin pedagogjik të MIT, të këshillojë për sponsorizimin e kërkimit dhe mundësitë e licencimit të teknologjisë dhe të lidhet me startup-et e lidhura me MIT. Elbit ka marrë pjesë gjithashtu në MIT ConnecTech, një program të Hillel (organizata më e madhe studentore çifute në botë) që lidh MIT me bizneset fillestare izraelite që tregojnë përkushtimin e thellë të MIT ndaj punës së Elbit. Në vitin 2021, Elbit Systems dhe KMC, filiali mjekësor i Elbit, njoftuan hapjen e tyre të një "qendre inovative" të re në Sheshin Qendror të Cambridge-it, në 130 Bishop Allen Drive. Qendra mburrej me qasje të lehtë për të diplomuarit në MIT dhe Harvard, si dhe shpresat e tyre për të rritur deri në 60 inxhinierë. Kjo nuk u realizua. Në fund të gushtit 2024, pas një fushate presioni një vjeçar nga aktivistët e komunitetit të zonës së Bostonit, u njoftua se Elbit Systems liroi zyrën e saj. Megjithatë, shkencëtarët e shqetësuar të MIT-it e dinë se ndikimi i Elbit është ende shumë i pranishëm përmes Programit të Ndërlidhjes Industriale. Është koha që MIT të ndjekë shembullin e mësipërm dhe t'i ndërpresë lidhjet me Elbit. Ka precedent për këtë.

Në vitin 2020, MIT mori vendimin për t'i dhënë fund angazhimeve të saj me Saudi Aramco në mes shqetësimeve për vrasjen e Jamal Khashoggi. Në vitin 2009, fondi i pensioneve të qeverisë së Norvegjisë u largua nga Elbit Systems për shkak të rolit të tij në furnizimin e teknologjisë për murin e aparteidit të Izraelit, i cili u konstatua si i paligjshëm nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Në vitin 2018, HSBC hoqi të gjitha zotërimet e saj nga Elbit Systems për shkak të prodhimit të bombave thërrmuese. Në tetor 2024, Banka Barclays shiti aksionet e saj në Elbit Systems, me vlerë mbi 3.4 milionë dollarë. MIT ka norma ekzistuese për të skualifikuar çdo firmë nga marrëdhëniet me MIT nëse ekzistojnë "prova të besueshme që aktivitetet e kompanisë kontribuojnë në shtypjen e të drejtave të njeriut në Sinkiang" ose nëse ajo ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me forcat e armatosura kineze. [64] Çdo shqetësim konsekuent për të drejtat e njeriut do ta shtrinte atë parim në Palestinë.

Maersk

Maersk është kompania më e madhe e transportit detar në botë. Nga tetori 2023 deri në qershor 2024, Maersk transportoi më shumë se 300 milionë dollarë komponentë armësh për prodhuesit kryesorë të armëve në SHBA. Një e katërta e dërgesave të identifikuara të komponentëve për Northrup Gruman, Woodward, Raytheon dhe Lockheed në SHBA janë anije të Maersk.[65] Rreth 69% e armëve të Izraelit dërgohen nga SHBA. Përveç avionëve dhe anijeve të ngarkesave ushtarake të SHBA-ve, vetë Maersk i dërgon ato armë si pjesë e Marrëveshjes së saj Vullnetare Ndërmodale Sealift (Voluntary Intermodal Sealift Agreement – VISA) dhe Programit të Sigurisë Detare (Maritime Security Program – MSP) me Departamentin e Mbrojtjes së SHBA-ve. Maersk transporton në mënyrë aktive miliona paund mallra ushtarake, duke përfshirë qindra automjete të blinduara dhe taktike dhe komponentët e tyre në ushtrinë izraelite për përdorim në Gaza. [66]

64 Richard Lester et al., "University Engagement with China: An MIT Approach," *The MIT China Strategy Group*, October 2022.

65 "Evidence of Maersk Shipments to Israeli Military," *Palestinian Youth Movement,* November 4, 2024.

66 Lennard, Natasha. "Shipping Giant Maersk Violated Spanish Embargo on Sending Military Goods to Israel, Researchers Say," *The Intercept*, 4 nëntor, 2024.

Maersk ka një partneritet me Qendrën për Transport dhe Logjistikë të MIT (MIT Center for Transport & Logistics). Që nga viti 2009, Maersk ka qenë një nga partnerët e shkëmbimit të zinxhirit të furnizimit të CTL, duke i dhënë qasje dhe rrjetëzim të privilegjuar hulumtuesve të CTL, logjistikës së transportit dhe simpoziumeve. Në 2021, Maersk njoftoi një "marrëveshje historike" me CTL për të thelluar marrëdhëniet e saj me studiues të lartë të CTL, si drejtori i CTL, Yossi Sheffi. Maersk që atëherë ka sponsorizuar dokumente të shumta kërkimore në MIT duke u fokusuar në automatizimin e industrisë së transportit detar, pavarësisht grevave në shkallë të gjerë të punonjësve të portit mbi politika të tilla. Në vitin 2023, Maersk njoftoi një bashkëpunim me portin Ashdod, duke deklaruar se bashkëpunimi "ndërtohet mbi një marrëveshje të mëparshme inovacioni" me MIT. Ashdod është një nga portet e shumta në Izrael dhe është i pozicionuar në mënyrë unike pranë Gazës. Porti Ashdod përkufizohet si "infrastrukturë thelbësore shtetërore" nga qeveria izraelite dhe 10% e punëtorëve të tij rekrutohen drejtpërdrejt nga ushtria izraelite. Ministria izraelite e Mbrojtjes konfirmoi se 2.500 ton armë u dërguan nga SHBA-të në portin e Ashdod në nëntor.

Kështu, Maersk ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me forcat e armatosura izraelite si një ofrues i sistemeve, produkteve ose shërbimeve me aplikime ushtarake dhe mbështet rrjedhën e armëve të përdorura në vrasjet masive të palestinezëve. Zgjedhja e MIT si një institucion prestigjioz për të bashkëpunuar me Maersk-un "legjitimon shkeljet e të drejtave politike, njerëzore ose civile" në Palestinë, për t'i bërë jehonë gjuhës së procesit të rishikimit të projektit me rrezik të lartë të MIT.

Në rrethana të tilla, MIT duhet të pezullojë menjëherë marrëveshjet e saj me Maersk-un. MIT ka norma ekzistuese për të skualifikuar çdo kompani nga të pasurit marrëdhënie me MIT nëse ka "prova të besueshme që aktivitetet e kompanisë kontribuojnë në shtypjen e të drejtave të njeriut në Sinkiang" ose nëse ajo ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me forcat e armatosura kineze. [67] Çdo shqetësim i vazhdueshëm për të drejtat e njeriut do ta shtrinte këtë parim në Palestinë.

Lockheed Martin

Lockheed Martin është një prodhues global i armëve që i ka shitur disa miliardë dollarë armë shtetit të aparteidit të Izraelit. Në veçanti, Lockheed ka furnizuar qeverinë izraelite me raketa AGM-1149R9X Hellfire, avionë sulmues F-16 dhe F-35 dhe artileri të rëndë të cilat ata i kanë përdorur për të shkatërruar shoqërinë palestineze në Gaza gjatë vitit të kaluar: shkollat, spitalet, universitetet, vendet e shenjta dhe infrastrukturën jetike të saj – duke vrarë drejtpërdrejt dhjetëra mijëra palestinezë dhe duke dëbuar miliona në këtë proces. Për shembull, raketat e Lockheed, Hellfire, u përdorën për të kryer masakrën e spitalit Esh-Shifa. Nëpërmjet armatimeve të saj, Lockheed ka përfituar nga lufta gjenocidale në Gaza dhe i ka mundësuar më tej qeverisë së krahut të djathtë të Benjamin Netanyahu, një ish-student i MIT, të drejtojë kampe torture në Sde Teiman dhe të imponojë një regjim aparteidi në Jerusalemin Lindor dhe Bregun Perëndimor.

67 Richard Lester et al., "University Engagement with China: An MIT Approach," The MIT China Strategy Group, Tetor 2022.

Që nga viti 2019, Iniciativa Ndërkombëtare e Shkencës dhe Teknologjisë Izrael e MIT (International Science and Technology Initiative Israel – MISTI-Israel) ka administruar një Fond Farë Lockheed Martin (Lockheed Martin Seed Fund) për të lidhur studentët dhe studiuesit në MIT me projektet e Lockheed Martin në Izrael. Mes presionit masiv, MISTI-Israel ndërpreu fondin e farës dhe stafi konfirmoi me shkrim se cikli i financimit nuk do të rinovohet. Programi përfundoi pas muajsh protestash, duke përfshirë dërgimin e letrave, protestat dhe një fushatë informimi publik. I përballur publikisht me fitoren, MIT ka thënë në jo bindshëm se fondi thjesht ka skaduar në fund të ciklit të tij. Realiteti është se parazgjedhja për kontrata të tilla është rinovimi, dhe rrallëherë institucionet që shpërblejnë pranojnë se e kanë bërë këtë për shkak të presionit të aktivistëve. [68] Ose MIT ose Lockheed Martin e ndjenë nxehtësinë dhe u tërhoqën.

Përpjekjet e Lockheed Martin për rekrutim u ndërprenë më tej në Panairin e Vjeshtës të Karrierës të MIT 2024 (MIT Fall Carrier Fair), ku një pankartë ku shkruhej "LOCKHEED VRET FËMIJËT NË GAZA" u shfaq lart dhe studentët u rreshtuan për të sfiduar rekrutuesit për përfitimin e Lockheed nga vrasja masive dhe emetimi i saj i milionave ton metrikë CO_2 në vitin 2024. Rekrutuesit u larguan tre orë më herët, të acaruar. [69] Kjo luftë vazhdon: Lockheed Martin ende sponsorizon fondet fillestare në MIT nën MISTI-Gjermani dhe MISTI-Poloni. Lockheed Martin ka qenë anëtar i Iniciativës për Energji të MIT (MIT Energy Initiative) që nga viti 2009. Në vitin 2017, ajo nënshkroi një 'marrëveshje master' për bashkëpunime kërkimore afatgjata me MIT, të udhëhequr nga Departamenti i Aeronautikës dhe Astronautikës i Institutit (Department of Aeronautics and Astronautics) dhe në bashkëpunim me Laboratorin për Shkenca Kompjuterike dhe të Inteligjencës Artificiale të MIT (Computer Science and Artificial Intelligence Laboratory).

Për të përmbledhur faktet, Lockheed Martin ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me forcat e armatosura izraelite si një ofrues i sistemeve, produkteve ose shërbimeve me zbatime ushtarake. Në kushte të tilla, zgjedhja e MIT për të vazhduar bashkëpunimin me Lockheed Martin legjitimon shkeljet e të drejtave politike, njerëzore ose civile në Palestinë. MIT ka norma ekzistuese për të skualifikuar çdo kompani nga marrëdhëniet me MIT nëse ekzistojnë "prova të besueshme që aktivitetet e kompanisë po kontribuojnë në shtypjen e të drejtave të njeriut në Sinkiang" ose nëse ajo ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me forcat e armatosura kineze. MIT ka shprehur gjithashtu angazhimet e veta për të minimizuar "ndikimet negative ndaj mjedisit, shëndetit dhe sigurisë" të aktiviteteve të Institutit. Çdo shqetësim i vazhdueshëm për të drejtat e njeriut dhe sigurinë do ta shtrinte këtë parim në Palestinë. MIT duhet të pezullojë menjëherë të gjitha bashkëpunimet me Lockheed Martin.

Pankarta "Roll Out" në Panairin e Vjeshtës të Karrierës të MIT 2024, 20 shtator, 2024

68 Dëshmi është, për shembull, përgjigjja e Puma-s pasi kapitulloi ndaj presionit të aktivistëve për t›i dhënë fund sponsorizimit të tyre ndaj Federatës së Futbollit të Izraelit.

69 Hana Flores and Kate Pearce. "Lockheed Leaves the Career Fair: Reflections on the Power of Principled Dissent," *The Tech*, 3 tetor, 2024.

Caterpillar

Caterpillar, Inc. prodhon një klasë të veçantë buldozerësh të blinduar për forcat e armatosura izraelite të quajtur D9. Këta buldozerë D9 përdoren në mënyrë rutinë për të prishur shtëpi, fabrika, tokë bujqësore dhe infrastrukturën civile në Palestinë. Në mars 2003, një ushtar izraelit që drejtonte një buldozer Caterpillar D9 vrau një aktiviste dhe studente amerikane kundër aparteidit, Rachel Corrie, gjatë një rrafshimi të shtëpive palestineze në Gaza. Në dy vitet e fundit, Izraeli ka përdorur buldozerë të tillë të armatosur për të pastruar komunitetet palestineze në Mesafer Jatta [70], për të shkaktuar ndëshkime kolektive mbi Tulkarem dhe Xhenin [71], për të rrafshuar shtëpitë e krishtera palestineze në Mahrour, Betlehem në përgatitje për zaptimin e tyre nga kolonët [72], dhe për të përdhosur kufomat në Gaza. Caterpillar, së bashku me Hyundai Heavy Industries, JCB dhe Volvo Group, është përballur kështu me kritika të arsyeshme nga komuniteti i të drejtave të njeriut për shitjet e saj të vazhdueshme ushtrisë izraelite, pavarësisht pretendimit të Caterpillar se produktet e saj duhet të përdoren "në përputhje me të drejtat e njeriut dhe kërkesat e ligjit humanitar ndërkombëtar"[73]

Caterpillar, Inc ka qenë një partner i MIT në programin Liderë për Operacione Globale (Leaders for Global Operations – LGO) që nga viti 2009. Në LGO, Caterpillar sponsorizon projekte kërkimore dhe praktika dhe gëzon qasje të privilegjuar në talentin dhe ekspertizën e MIT për rekrutimin e tij. Në të kaluarën, Caterpillar ka sponsorizuar kërkimin e supozuar "të paanshëm" të Programit të Përbashkët të MIT mbi Shkencën dhe Politikën e Ndryshimit Global (MIT Joint Program on the Science and Policy of Global Change) dhe aktualisht është anëtar i Aleancave CSAIL të MIT – si një "portë në Laboratorin e Shkencave Kompjuterike dhe Inteligjencës Artificiale të MIT".

Kjo është e njëjta kompani Caterpillar që armatos një ushtri që kryen masakra ndaj palestinezëve si pjesë e një projekti kolonial të ardhacakëve të shekullit të 21-të në territoret e pushtuara. Caterpillar ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me forcat e armatosura izraelite si një ofrues i sistemeve, produkteve ose shërbimeve me zbatime ushtarake, të cilat përdoren në mënyrë rutinë për të kryer shkelje të të drejtave të njeriut. Në kushte të tilla, zgjedhja e MIT për të vazhduar bashkëpunimin me Caterpillar legjitimon shkeljet e të drejtave politike, njerëzore ose civile në Palestinë dhe inkurajon talentin dhe ekspertizën e MIT për t'u rekrutuar në krimet e Caterpillar.

MIT ka norma ekzistuese për të skualifikuar çdo kompani nga marrëdhëniet me MIT nëse ekzistojnë "prova të besueshme që aktivitetet e kompanisë po kontribuojnë në shtypjen e të drejtave të njeriut në Sinkiang" ose nëse ajo ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me forcat e armatosura kineze. MIT ka shprehur gjithashtu angazhimet e veta për të minimizuar "ndikimet negative ndaj mjedisit, shëndetit dhe sigurisë" të aktiviteteve të Institutit. Çdo shqetësim i vazhdueshëm për të drejtat e njeriut do t'i shtrinte këto parime në Palestinë. MIT duhet t'i pezullojë menjëherë të gjitha bashkëpunimet me Caterpillar.

70 Shih *No Other Land* (2024), film dokumentar, në produksion të Yuval Avraham, Basel Adra, Hamdan Ballal, dhe Rachel Szor.

71 Erika Solomon, Lauren Leatherby, and Aric Toler. "Israeli Bulldozers Flatten Mile After Mile in the West Bank," *The New York Times*, 25 shtator, 2024.

72 Chahuneau, Louis. "'We're Not Afraid': French-Palestinian Family Fights for West Bank Land Seized by Israeli Settlers," *France 24*, 2 shtator, 2024.

73 "Caterpillar Inc's Role in Human Rights Violations in the Occupied Palestinian Territories," *Amnesty International*, 23 dhjetor, 2010. Shih gjithashtu raportet për Caterpillar nga Human Rights Watch dhe Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut të OKB.

Shtypja globale dhe përtej kësaj

Këto katër kompani – Caterpillar, Lockheed Martin, Maersk dhe Elbit – janë maja e akullnajës. Dikush mund të zbulojë lehtësisht raste të tjera. **Raytheon** (tani RTX), i cili doli nga MIT dhe mban lidhje të ngushta me MIT, e furnizon qeverinë izraelite me raketa dhe bomba 4000 lb (rreth 1800 kg) të quajtura GBU-28. Nga viti 2021 deri në 2023, Boeing prodhoi më shumë bomba dhe municione të drejtuara për Izraelin se çdo kompani tjetër amerikane, dhe **Boeing** është ngulitur në bashkëpunimet e MIT; për shembull, **Aurora Flight Sciences**, një degë e Boeing e cila hulumton "sistemet autonome të fluturimit" aktualisht ka marrë me qira hapësirën e punës nga MIT në 314 Main Street në Cambridge. **Google** dhe **Amazon** i ofrojnë ushtrisë izraelite shërbime kompjuterike cloud dhe inteligjencë artificiale nën **Projektin Nimbus** dhe vazhdojnë të gëzojnë marrëdhënie të privilegjuara, të mbështetura institucionalisht me studiuesit e MIT. Përtej Palestinës, MITdesignX Dubai bashkëpunon me **Silicon Oasis**, një degë e qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, e cila sponsorizon një milici gjenocidale në Sudan të quajtur Forcat e Mbështetjes së Shpejtë.

Duke parë grupimet e tjera të pushtetit institucional, MIT refuzon të nënshkruajë Parimet e OKB-së për Investime të Përgjegjshme ose t'i zbulojë zotërimet e saj financiare neto prej 32 miliardë dollarësh. Nëse hetimet në Harvard janë ndonjë udhëzues, fondi i MIT ka të ngjarë të zotërojë asete në industritë e karburanteve fosile dhe kompanitë që mbështesin projektin e kolonëve sionistë në Palestinën e pushtuar. MIT gjithashtu shquhet në mënyrë të veçantë si i vetmi universitet amerikan që strehon një laborator armësh të klasifikuara, i cili financohet tërësisht nga Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-ve. **MIT Lincoln Laboratory** aktualisht ka një kontratë 20 miliardë dollarë për periudhën 2015-2025 dhe kryen kërkime të klasifikuara në: balistikë, vëzhgim, radarë dhe luftë kibernetike. Si një FFRDC, frytet e kërkimit të Lincoln Lab u shpërndahen më vonë kontraktuesve të mbrojtjes, të cilët testojnë, fitojnë para dhe përfundimisht i tregtojnë këto teknologji në shtetet klientë të SHBA-ve si Izraeli. Në kushte të tilla, mund të duket joreale ose e frikshme të kërkosh ndryshim në MIT. Megjithatë, udhëtimi prej një mijë miljesh fillon me një hap të vetëm, dhe rregullat e MIT-it e kërkojnë këtë. Për më tepër, MIT u ka dhënë fund bashkëpunimet dhe ka hequr dorë në të kaluarën. Kjo mund të bëhet përsëri.

Seksioni 4: Fushata jonë

Studentët e MIT-it rimarrin Kampin e Shkencëtarëve kundër Gjenocidit (Scientists Against Genocide), 6 maj 2024 © Brian Snyder | Reuters
Studentët e MIT kërkojnë drejtësi për Palestinën dhe përfundimin e lidhjeve kërkimore të MIT me Izraelin, Mars 2024

Seksioni 4:
Fushata jonë dhe vetë rregullat e MIT

4.1: Kërkesat e Koalicionit për Palestinën të MIT që nga viti 2023

Në tetor të vitit 2023, mbi 15 grupe studentore formuan Koalicionin për Palestinën të MIT me një kërkesë thelbësore për t'i dhënë fund sponsorizimit të kërkimit nga Ministria e Mbrojtjes e Izraelit (IMoD). Studentët e MIT mbajtën ecje në këmbë, vigjilje, mësime, protesta dhe ulje në vend në disa raste. Më e spikatura prej tyre ishte më 9 nëntor dhe 12 shkurt, kur studentët e MIT organizuan një protestë historike në Lobin 7 të MIT, i njëjti vend ku studentët e MIT në të kaluarën kanë demonstruar kundër Luftës së Vietnamit dhe brutalitetit policor kundër të zinjve. Në përgjigje, administratorët kërcënuan pjesëmarrësit me pezullim. Policia e MIT mbylli më pas ngjarjet e planifikuara të mësimdhënies dhe lejoi provokatorët t'i ngacmonin dhe në disa raste t'i sulmonin studentët. Më 13 shkurt, presidentja Sally Kornbluth dërgoi një letër në të gjithë kampusin duke ndaluar zyrtarisht Koalicionin Kundër Aparteidit (Coalition Against Apartheid – CAA) nën një zbatim shumë selektiv të rregullave; Uebfaqja e CAA-së u mbyll, më shumë se një duzinë studentë organizatorë u sanksionuan zyrtarisht dhe punëtorëve të diplomuar iu mohua e drejta për përfaqësim sindikal në procesin disiplinor.

Komuniteti MIT nuk u dorëzua butësisht. Më 23 mars, studentët votuan me 63% në një referendum në të gjithë kampusin me pjesëmarrjen më të madhe që mbahet mend për të bërë thirrje për një armëpushim në Gaza, për të qëndruar me organizatorët e studentëve për Palestinën dhe për t'i ndërprerë të gjitha lidhjet kërkimore dhe financiare me ushtrinë izraelite.[74] Më 19 prill, anëtarët e Unionit Studentor të të Diplomuarve të MIT (Graduate Student Union), ose United Electric 256, votuan me mbi 70,5 për qind në një referendum për të ratifikuar një rezolutë të ngjashme. Mijëra nënshkruan zotimin "Nuk ka shkencë për aparteidin". Megjithatë, administratorët e MIT i refuzuan kërkesat e organizatorëve të koalicionit për të diskutuar mbi distancimin.

Kjo ndryshoi kur kampi i Shkencëtarët Kundër Gjenocidit (Scientists Against Genocide) u formua në prill të vitit 2024 në fushën me bar Kresge, ku në vitin 1987 Koalicioni Kundër Aparteidit origjinal ngriti kampin për t'i bërë presion MIT që të largohej nga Afrika e Jugut e aparteidit. Anëtarët e koalicionit siguruan një takim me administratorët e MIT për të paraqitur kërkesat me shkrim, të cilat përfshinin para së gjithash "refuzimin e çdo ndikimi aktual dhe të ardhshëm direkt ose indirekt të Ministrisë së Mbrojtjes së Izraelit në projektet kërkimore në MIT". Përfshihej gjithashtu dhënia fund përfshirjes së IMoD-së në "iniciativat globale jo-kërkuese" të tilla si praktikat dhe programet e studimit jashtë vendit.

Në takimin e parë të 26 prillit, administratorët e MIT e hodhën poshtë propozimin dhe ofruan, në vend të kësaj, një modifikim të paqartë dhe të paspecifikuar në procesin e shqyrtimit të granteve të MIT. Ata u kërkuan studentëve ta trajtojnë këtë lëshim simbolik si një "fitore të madhe" dhe t'i japin fund kampingut, me kërcënimin e nënkuptuar se "nuk ka përfunduar mirë kur gjërat shtyhen përtej kësaj". Negociatorët e koalicionit refuzuan. Në takimet në vijim, koalicioni dha një propozim të ndryshuar me shkrim për të zbatuar udhëzimet ekzistuese Suri të MIT për të refuzuar grantet nga organizatat e përfshira në shkelje të të drejtave të njeriut.

Administratorët nuk arritën të premtonin zbatimin e politikës ekzistuese të MIT dhe argumentuan se Ministria e Mbrojtjes e Izraelit nuk mund të refuzohej si sponsor për shkak të "nuancës" së situatës.[75] Më vonë, Kancelari i MIT-it pretendoi se përfundimi i sponsorizimeve ushtarake izraelite në MIT do të cenonte 'lirinë akademike'.

Kjo u pasua nga valë represioni për të shuar disidencën.[76] Më 3 maj, policia e MIT ndërtoi një unazë gardhesh dhe një pikë kontrolli për të mbyllur kampin. Më 10 maj e shkatërruan atë. Gjatë pranverës dhe verës së vitit 2024, autoritetet e MIT arrestuan, dëbuan dhe pezulluan dhjetëra organizatorë, duke zgjedhur kryesisht studentë me ngjyrë. Në vitin akademik 2023-2024, rreth 45 nga 52 raste të Komitetit për Disiplinë (87%) synonin studentët me ngjyrë. Organet e koalicionit si Taara, Çifutët për Çlirimin Kolektiv, Unioni i Studentëve të Zinj dhe Organizata e Studentëve Arabë u ballafaquan me një mori pengesash dhe disipline burokratike. Kufizimet për fllajerë, postera, tabelizime, vigjilje dhe shfaqje filmash u shtrënguan. Nënkryetari dhe punonjësi me kohë të plotë i sindikatës United Electric Local 256 të MIT-it u ndaluan nga kampusi për një kohë të pacaktuar. Koalicioni Kundër Aparteidit u ndalua përgjithmonë. Nga gushti deri në nëntor 2024, policia arrestoi pesë persona në protestat e MIT, të gjithë të minoriteteve. Disa të tjerë morën letra disiplinore për t'u bërë pyetje rekrutuesve në një panair karriere. Në nëntor, një edicion i botimit studentor Written Revolution dhe kryeredaktori i tij u ndaluan nga kampusi për një artikull që diskutonte kufijtë e pacifizmit.

74 Jonathan Anziani, Hannah Didehbani, and Amira Ravshanova. "In Support of Science for Liberation, Not Oppression: Vote YES," *The Tech*, 21 mars, 2024.

75 Metzger, Jessica. "Research for Human Rights Abuses: How MIT Breaks Its Own Rules," *The Tech*, 3 tetor, 2024.

76 Shkalla dhe taktikat e rezistencës së MIT ndaj këtij represioni janë rrëfyer në detaje në seksionin e opinioneve të *The Tech dhe medias së* Koalicionit për Palestinën të MIT.

4.2: Rregullat dhe boligimet e vetë MIT

E vërteta është se MIT ka politika dhe norma ekzistuese që detyrojnë veprim të shpejtë për t'i dhënë fund të gjitha bashkëpunimeve të MIT me qeverinë izraelite dhe kontraktuesit e saj ushtarakë. Këto shqetësime tejkalojnë kundërshtimet për lirinë akademike dhe përfshijnë sa vijon:

- Udhëzimet Suri të MIT për financimin etik
- Rregullat e MIT për angazhimet e huaja
- Pritjet e MIT për etikën shkencore
- Politikat e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë të MIT
- Ndalimi i MIT për përdorimin e pahijshëm të pronës së Institutit
- Politika e MIT për Mirëqenien e Komunitetit.
- Misioni i MIT
- Ligji federal dhe ndërkombëtar

Pasi aktivistët ekspozuan skandalin e lidhjeve të MIT me Jeffrey Epstein dhe monarkinë saudite, presidenti i MIT porositi një raport për të adresuar çështjet etike në donacionet dhe sponsorizimet kërkimore. Ky Raport Suri 2020 vendosi udhëzime dhe një protokoll me anë të të cilit do të vlerësoheshin "angazhimet e jashtme" duke përfshirë "grantet, dhuratat dhe çfarëdo asociacionesh dhe bashkëpunim tjetër që përfshin MIT me qeveri, korporata, fondacione ose individë privatë, vendas ose të huaj". Udhëzimet Suri, megjithëse nuk janë përfshirë kurrë zyrtarisht në politikën e MIT, janë të disponueshme në faqen e qeverisjes së trupit pedagogjik të MIT dhe në një listë raportesh zyrtare të MIT, duke i bërë ato rekomandime publike, gjoja-zyrtare për trupin pedagogjik dhe PI-të. Udhëzimet udhëzojnë fakultetin dhe stafin e MIT që të refuzojnë automatikisht angazhimet ose sponsorizimet nga organizatat, përfshirë ministritë qeveritare, që kodojnë "po" për cilindo nga kriteret e numëruara:

> *Ky partner institucional a* është angazhuar *drejtpërdrejt, a ka mbështetur apo financuar ndonjë shkelje të rëndë të të drejtave politike, civile apo të njeriut?*
>
> *A përfshijnë politikat e partnerit institucional dhe zbatimi i tyre në këtë angazhim një shkelje të rëndë të të drejtave politike, civile apo të njeriut?"*

Raporti i përkufizon të drejtat politike, civile dhe të njeriut me sa vijon:

> *"**Të drejtat politike*** përfshijnë drejtësinë procedurale në ligj, siç janë të drejtat e të akuzuarit, duke përfshirë të drejtën për një gjykim të drejtë; procesi i rregullt ligjor; e drejta për të kërkuar kompensim ose mjet juridik; dhe të drejtat e pjesëmarrjes në shoqërinë civile dhe politikë, si: *liria e organizimit, e drejta për t'u mbledhur, e drejta për peticion, e drejta e vetëmbrojtjes dhe e drejta për të votuar.*
>
> ***Të drejtat civile*** përfshijnë sigurimin e integritetit fizik dhe mendor të njerëzve, jetës dhe sigurisë; mbrojtjen nga diskriminimi në baza të tilla si: *raca, gjinia, orientimi seksual, origjina kombëtare, ngjyra, mosha, përkatësia politike, etnia, feja dhe paaftësia; dhe të drejtat individuale si: privatësia dhe liria e mendimit, fjalës, fesë, shtypit, tubimit dhe lëvizjes.*
>
> *Për **të drejtat e njeriut**, megjithëse nuk janë të përcaktuara zyrtarisht në të drejtën ndërkombëtare, "shkeljet e rënda"* nënkuptojnë llojet e shkeljeve që prekin në terma cilësorë dhe sasiorë të drejtat më themelore të qenieve njerëzore, veçanërisht të drejtën për jetë dhe të drejtën për integritet fizik dhe moral të person*it njerëzor… Përgjithësisht supozohet se gjenocidi, skllavëria dhe tregtia me skllevër, vrasja, zhdukjet me forcë, torturat ose trajtime ose ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzor ose poshtëruese, ndalimi arbitrar i zgjatur, dëbimi ose transferimi i dhunshëm i popullsisë dhe diskriminimi sistematik racor hyjnë në këtë kategori. Privimi i qëllimshëm dhe sistematik i ushqimeve thelbësore, kujdesit parësor shëndetësor thelbësor, ose strehimit dhe vendbanimit bazë mund të çojë gjithashtu në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut".*

Konsiderata të tilla përshkojnë **udhëzimet zyrtare të MIT**. Për shembull, "Procesi i Rishikimit të Rrezikut të Rritur" të MIT vlerëson projektet e MIT të financuara nga njerëz ose subjekte në Kinë, Rusi dhe Arabinë Saudite. Ndërsa aktualisht kërkohet vetëm për të aplikuar në këto vende, vendet e tjera "mund të jenë subjekt i rishikimit" ndërsa rrethanat globale ndryshojnë. Ai i rendit çështjet e mëposhtme si të rëndësishme në procesin e rishikimit të rrezikut të ngritur:

> ***Rreziku politik, civil dhe i të drejtave të njeriut****: rreziku që rezultatet e hulumtimit do të përdoren në mënyra që do të cenonin të drejtat politike, njerëzore ose civile në një vend të huaj, ose që angazhimi do të legjitimojë në mënyrë indirekte shkeljet e të drejtave politike, njerëzore ose civile në atë vend.*
>
> *Rreziku për komunitetin e MIT për të ofruar mbështetje për veprime që bien ndesh me vlerat thelbësore të MIT, ose që nuk janë në përputhje me misionin e tij akademik, ose që mund të çojë në diskriminim midis anëtarëve të komunitetit tonë, ose që do të lejonte ndikim të jashtëm të panevojshëm mbi drejtimin e* kërkimit ose *arsimit* në MIT.

Më konkretisht, raporti i Grupit për Strategjinë me Kinën (MIT China Strategy Group) për vitin 2022 mbi angazhimet universitare me Kinën rendit rrethanat që duhet të skualifikojnë një kompani nga të pasurit një marrëdhënie me MIT si më poshtë:

> *Çdo përfshirje e drejtpërdrejtë në aktivitetet e inteligjencës qeveritare ose një marrëdhënie e drejtpërdrejtë me forcat e armatosura kineze si ofrues i sistemeve, produkteve ose shërbimeve me aplikime ushtarake;*
>
> *Dëshmi të besueshme se aktivitetet e kompanisë kontribuojnë në shtypjen e të drejtave të njeriut në Sinkiang ose gjetkë në Kinë.*[77]

Çfarëdo shqetësim moralisht i qëndrueshëm për të drejtat e njeriut do t'i shtrinte këto parime në Palestinë. Ministria e Mbrojtjes e Izraelit (IMoD) është krahu i armatosur i qeverisë izraelite. Siç është detajuar në mënyrë shteruese në seksionet e këtij raporti me titull Gjenocidi i Gazës dhe Kolonializmi i ardhacakëve, ai është i përfshirë drejtpërdrejt në krimin e gjenocidit në Gaza dhe në shtypjen e ashpër dhe në shkallë të gjerë të të drejtave të njeriut në territoret e pushtuara palestineze dhe në Izrael. Këto përfshijnë të drejtat palestineze për *habeas corpus*, lirinë e organizimit, grumbullimit, adhurimit, vetëmbrojtjes, votimit, integritetit fizik dhe mendor, vetë jetës dhe të drejtën për mbrojtje nga diskriminimi për shkaqe të tilla si: raca, origjina kombëtare dhe përkatësia etnike.

Siç është detajuar në mënyrë shteruese në seksionet Gjenocidi në Gaza dhe Nakba të këtij raporti, Ministria izraelite e Mbrojtjes (IMoD) është përgjegjëse për krimet e: gjenocidit, vrasjes, zhdukjeve me forcë, torturës, trajtimit mizor dhe poshtërues, ndalimit të zgjatur arbitrar, dëbimit, transferimit të dhunshëm të popullsisë, urisë dhe diskriminimi sistematik racor. **Nëse MIT nuk u lejon Hetuesve Parësorë "lirinë akademike"** të pakualifikuar që kërkimet e tyre të sponsorizohen nga Aramco saudite për shkak të krimeve nga monarkia saudite, pse duhet të lejojë kërkime të sponsorizuara nga forcat e armatosura izraelite duke pasur parasysh **krimet e saj të tmerrshme kundër palestinezëve?** Nëse MIT skualifikon ndonjë kompani nga një marrëdhënie me MIT nëse furnizon "sisteme, produkte ose shërbime me aplikacione ushtarake" për ushtrinë kineze, MIT duhet të skualifikojë Elbit, Lockheed Martin dhe Maersk, të cilat furnizojnë produkte me aplikacione ushtarake për ushtrinë izraelite.

77 Richard Lester et al., "University Engagement with China: An MIT Approach," The MIT China Strategy Group, Tetor 2022.

4.3: Rregullat e MIT dhe Ligji Federal

Lidhjet e MIT me IMoD dhe kontraktuesit e tij shkelin politika të tjera të MIT. Politika për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë e MIT (9.14.1) thotë se Instituti është i përkushtuar për të "minimizuar ndikimet negative mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë" të aktiviteteve dhe operacioneve të tij në nivel global. Sponsorizimi i kërkimit dhe bashkëpunimi institucional janë aktivitete të Institutit, por MIT nuk merr parasysh shëndetin, sigurinë dhe mjedisin e palestinezëve në Gaza kur mbështet shtypësit e tyre me bashkëpunime institucionale. Zyra e Zëvendës Presidentit për Kërkime të MIT (Vice President for Research – VPR) pretendon se "përmirësimi i njerëzimit" është një "objektiv kryesor i bashkëpunimeve kërkimore". Në të vërtetë, "përmirësimit të njerëzimit" i jepet një rol qendror në deklaratën e misionit të MIT. Megjithatë, palestinezët janë pjesëtarë të njerëzimit dhe dinjiteti i tyre njerëzor nuk merret parasysh nga MIT kur bashkëpunon me fuqinë ushtarake okupuese. VPR gjithashtu thekson se "MIT pret që të gjithë studiuesit në MIT të kryejnë punën e tyre sipas standardeve më të larta etike dhe profesionale". Hulumtimi i sponsorizuar nga një entitet i huaj që kryen gjenocid nuk është etik.

Libri Mind and Hand (Mendja dhe Dora) i MIT thekson se Instituti pret që anëtarët e komunitetit MIT të mos përfshihen në sjellje që kanë pasoja serioze për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e të tjerëve dhe se është përgjegjësi e "Institutit të marrë parasysh mirëqenien e komuniteti." Kryerja e kërkimit të sponsorizuar nga një ushtri e huaj që kryen gjenocid ka pasoja serioze për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e palestinezëve dhe studentëve të tjerë me bindje morale.

Libri Mind and Hand i MIT thotë më tej se MIT ndalon përdorimin e pahijshëm të pronës ose objekteve të Institutit, duke përfshirë për aktivitete të paligjshme. Bashkëfajësia në gjenocid, duke përfshirë kërkimin bashkëfajtor, është një aktivitet i paligjshëm sipas nenit 3 të Konventës së Gjenocidit të vitit 1951. Menaxheri i dotacionit të MIT premton të "kufizohemi në zgjedhjet e investimeve që përputhen me vlerat e MIT". MIT investon në kompani dhe marrëdhënie me kompanitë që përfitojnë nga gjenocidi. Ligji federal përjashton veprimtarinë e Institutit që diskriminon në bazë të përkatësisë etnike ose kombëtare, kurse MIT deklaron se është e angazhuar për "eliminimin e racizmit dhe sjelljes raciste". Megjithatë, MIT bashkëpunon me një ushtri të huaj që zbaton një regjim të segregacionit sistematik racor në Palestinë.

Ligji Federal penalizon mbështetjen materiale për terrorizmin. Organizatat e huaja terroriste (Foreign Terrorist Organizations – FTO) përcaktohen nga Sekretari i Shtetit të SHBA-së si: (1) organizata të huaja që (2) angazhohen në "veprimtari terroriste" të përcaktuar sipas Aktit të Emigracionit dhe Shtetësisë për të përfshirë përdorimin e çdo "eksplozivi, armë zjarri ose armë" me qëllim të rrezikimit të sigurisë së individëve ose "shkaktimit të dëmeve të konsiderueshme në pronë". Për të qenë një FTO, ky aktivitet duhet (3) të kërcënojë sigurinë e shtetasve amerikanë. Ushtria izraelite dhe grupet e armatosura të kolonëve izraelitë janë organizata të huaja. Ata përdorin eksplozivë dhe armë zjarri me qëllim të vrasjes së shtetasve të SHBA dhe e shkatërrojnë në mënyrë substanciale pronën e shtetasve të SHBA në Gaza dhe Bregun Perëndimor. [78] Sipas një zbatimi të qëndrueshëm të përkufizimit, ushtria izraelite është një organizatë e huaj terroriste. Pra, mbështetja materiale e MIT për të nëpërmjet kërkimit shkencor është një krim.

78 Shembuj të kësaj përfshijnë vrasjen e shtetases së SHBA Ayşenur Ezgi Eygi, Tawfic Abdel Jabbar, Mohammad Alkhdour, Jacob Flickinger, dhe Rachel Corrie.

4.4: Ukraina, Darfuri dhe Sinkiang

Dhënia fund lidhjeve të MIT me gjenocidin në Palestinë nuk cenon lirinë akademike. Në vitin 2022, MIT i dha fund në mënyrë të njëanshme bashkëpunimit të tij me Institutin e Shkencës dhe Teknologjisë Skolkovo në Moskë (në krijimin e të cilit kishte ndihmuar) një ditë pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Dyzet e pesë grante u ndërprenë menjëherë, duke ndikuar tek 26 PI. [79] Programet e shkëmbimit, rrugët e rekrutimit dhe orët mësimore Skoltech të mësuara nga MIT u anuluan, krahas këtyre granteve. Sponsorizimi i grantit përbënte 0.3% të buxhetit të MIT – dhjetë herë më shumë se sponsorizimi aktual IMoD. MIT i dha fund në mënyrë të njëanshme lidhjes së tij me Skoltech, anuloi çdo protestë për lirinë akademike dhe siguroi fonde kalimtare për shkencëtarët e prekur. Hulumtimi vazhdoi. Kancelari i MIT pretendon se Skoltech mund të përfundonte sepse ishte një "angazhim programor në nivel instituti". Nëse është kështu, atëherë MIT mund t'i japë fund publikisht anëtarësimit të Elbit Systems në Programin e Ndërlidhjes Industriale dhe Maersk në Qendrën për Transportin dhe Logjistikën, të cilat janë gjithashtu angazhime në nivel të Institutit.

Edhe përkundër shqetësimeve për lirinë akademike, MIT gjithashtu mund ta dënojë publikisht gjenocidin dhe aparteidin e mbështetur nga Izraeli, të shprehë solidaritet me Palestinën dhe ta bëjë publik angazhimin e saj të brendshëm të supozuar se "studentët dhe doktorët e shkencave që nuk ishin të kënaqur duke punuar në projektet e financuara nga [IMoD] mund të merrnin financim alternativ nga Instituti". MIT ka bërë deklarata të guximshme edhe më parë. Në vitin 2022, Presidenti i MIT e cilësoi tërheqjen e Skoltech si një "refuzim të veprimeve të qeverisë ruse në Ukrainë". MISTI-Rusia tha se "dënon pushtimin ushtarak të Ukrainës nga Federata Ruse. Ne qëndrojmë në solidaritet me popullin e Ukrainës që po invadohet dhe pushtohet në këtë luftë të pajustifikuar agresioni".

MIT më pas nisi Programin MIT-Ukrainë me qëllimin e deklaruar të "mobilizimit të ekspertizës shkencore dhe teknike të MIT në mbështetje të Ukrainës". Në fakt, nëse MIT do të angazhohej për lirinë akademike në kuptimin më të plotë, do të zgjeronte mundësi të ngjashme për studiuesit, studentët dhe institucionet shkencore palestineze. Në vend të kësaj, MIT në dukje ka bërë të kundërtën duke "thelluar lidhjet me studiuesit izraelitë" përmes programit Kalaniyot.

Ngritja palestineze (2023) nga Tafari Melisizwe

79 Shih Brown Books për 2022 dhe 2023 për projektet e sakta.

Deklarata të tilla të guximshme nuk janë të izoluara vetëm për Ukrainë. Në vitin 2007, MIT tha se refuzon "aktet e neveritshme" të gjenocidit në rajonin e Darfurit të Sudanit dhe u zotua të hiqte dorë nga dhurimi prej 10 miliardë dollarësh i portofoleve dhe letrave me vlerë. Në vitin 2020, MIT ndërpreu një bashkëpunim kërkimor CSAIL me iFlytek, një kompani kineze e inteligjencës artificiale e akuzuar për furnizim me teknologji për mbikëqyrjen e muslimanëve ujgurë në provincën e Sinkiangut. Në të kundërt, zyrtarët e MIT nuk kanë shprehur asnjë pikë solidariteti për Palestinën si një kolektiv kombëtar. MIT nuk e ka njohur natyrën e krimeve të kryera kundër popullit palestinez, duke parapëlqyer të bëjë gjeste të paqarta për "konfliktin në Lindjen e Mesme" ose ndryshe të qetësojë temperamentin e brishtë të sionistëve të saj përmes sulmeve të përsëritura dhe të zëshme ndaj aktivistëve të MIT. Për më tepër, kërkesat aktuale të Koalicionit për Palestinën të MIT janë më modeste se tërheqja e Skoltech. Koalicioni nuk kërkon pezullimin me shumicë të MISTI-Izrael, granteve apo programeve izraelite. Ai është përqendruar në mënyrë eksplicite në përfundimin e lidhjeve të MIT me ushtrinë izraelite dhe kontraktuesit e saj.

4.5: Jeffrey Epstein dhe Aramco saudite

Ndoshta precedenti më i fortë i MIT në kujtesën e fundit për përfundimin e lidhjeve kërkimore dhe financiare ndaj akteve të neveritshme janë lidhjet e MIT me Jeffrey Epstein dhe Aramco-n saudite. Jeffrey Epstein ishte një pedofil i dënuar dhe trafikant seksual i fëmijëve, i cili i dha 850.000 dollarë profesorit Seth Lloyd dhe MIT Media Lab nën drejtorin e tij Joi Ito, pavarësisht se ata dhe administratorët e lartë e dinin statusin e tij si kundërvajtës seksual i Nivelit të 3-të.

Trupi pedagogjik dhe zyrtarët e MIT fshehën pedofilinë e tij dhe e sollën Epstein-in në kampus nëntë herë gjatë disa viteve, pavarësisht nga rreziqet e mundshme që ai paraqiste si një grabitqar seksual për komunitetin e MIT.[80] Në vitin 2019 nën kritikat e aktivistëve dhe gazetarëve hetues, Presidenti i MIT Reif ofroi një "falje të përulur dhe të përzemërt" për lejimin e MIT të "kontribuojë në ngritjen e reputacionit [të Epstein]".

Presidenti i MIT-it deklaroi më tej se megjithëse trupi pedagogjik gëzon "liri të madhe në kryerjen dhe ndërtimin e mbështetjes për kërkimin e tyre", trupi pedagogjik nuk është "më vete"; dhe vendimet e tyre për dhuratat janë "gjithmonë subjekt i proceseve dhe parimeve të vjetra të Institutit". Një shumë e barabartë me donacionet e Epstein-it u zotua për të mbështetur të mbijetuarit e dhunës seksuale të Epstein-it.

Në asnjë moment të këtij skandali zyrtarë të lartë të MIT nuk iu shmangën publikisht çështjes, ose nuk u përfshinë në arsyetim të motivuar mbi "lirinë akademike" të laboratorëve ose studiuesve të MIT për të pranuar donacione ose sponsorizime nga Jeffrey Epstein.

Sinjalizimi i MIT ishte i qartë, i fuqishëm dhe faljekërkues. Nëse MIT ndërpreu lidhjet me Epstein për abuzim seksual me 36 fëmijë, sa më shumë duhet t'i ndërpresë lidhjet kërkimore me një ushtri të huaj për vrasjen e 11.000 fëmijëve në Gaza? [81] Ministria e Mbrojtjes e Izraelit ka vëzhguar dhunë pa bërë dallim ushtarake, [82] politikë të urisë së detyruar [83], dhe aktet e urryera të dhunës seksuale në kampet e paraburgimit si Sde Teiman. [84]

80 Farrow, Ronan. "How an Élite University Research Center Concealed Its Relationship with Jeffrey Epstein." *The New Yorker*, 6 shtator, 2019.

81 "More Women and Children Killed in Gaza by Israeli Military Than Any Other Recent Conflict in a Single Year," *Oxfam International*, 30 shtator, 2024.

82 "Israeli Forces' Conduct in Gaza," *Human Rights Watch*, 19 mars, 2024.

83 Murphy, Brett. "Israel Deliberately Blocked Humanitarian Aid to Gaza, Two Government Bodies Concluded. Antony Blinken Rejected Them." *Pro-Publica*, 24 shtator, 2024. <?>

84 "Welcome to Hell: The Israeli Prison System as Network of Torture Camps," *B'Tselem*, gusht 2024.
Also Patrick Kingsley and Bilal Shbair. "Inside the Base Where Israel Has Detained Thousands of Gazans." *The New York Times*, 6 qershor, 2024.

Ngjashëm si me rastin Epstein, MIT rivlerësoi marrëdhëniet e saj me Arabinë Saudite në 2019. Nën kritikat e aktivistëve, Presidenti i MIT njoftoi se “MIT dënon plotësisht shkelje të tilla brutale të të drejtave të njeriut, diskriminim dhe shtypje të mospajtimit” pas vrasjes së orkestruar nga shteti të gazetarit disident Jamal Khashoggi. Një vit më vonë, kundër kundërshtimit të trupit pedagogjik, MIT u zotua t’i jepte fund pjesëmarrjes së gjigantit të naftës në pronësi shtetërore Aramco saudite në Iniciativën e Energjisë të MIT dhe të refuzojë pafundësisht çdo angazhim të mëtejshëm ose sponsorizim kërkimor fitimprurës nga Aramco saudite. Ata e bënë këtë për një gazetar. Në vitin e kaluar të paktën 160 gazetarë janë vrarë. Vendimi për Aramco u formua nga rekomandimet e Grupit të Lartë të Rrezikut të MIT dhe një Komiteti Këshillimor Ndërkombëtar (IAC) i krijuar për të adresuar etikën në angazhimet e jashtme. Ky është i njëjti komitet i kryesuar nga prof. Suri, udhëzimet e të cilit, nëse ndiqen, do të ndalonin sponsorizimet nga Ministria izraelite e Mbrojtjes dhe furnizuesit e saj të armëve.



Palestina e Pushtuar cituar në *Filistin el-Mehtel-leh* (1952)

Seksioni 5:

Veprimet e menjëhershme dhe hapat e ardhshëm



Nablusi i pushtuar në Intifadën e Parë (1988)

Seksioni 5:
Veprimet e menjëhershme dhe hapat e ardhshëm

Duke pasur parasysh faktet e mësipërme, administrata e MIT duhet (1) t'iu japë fund menjëherë dhe publikisht të gjitha financimeve dhe sponsorizimeve të kërkimit nga ministria izraelite e mbrojtjes. Ajo duhet të angazhohet për sigurimin e fondeve kalimtare për projektet kërkimore të prekur. Ajo duhet (2) ta dënojë publikisht gjenocidin izraelit në Gaza, si dhe politikat e vazhdueshme izraelite të aparteidit dhe pushtimit. Ajo duhet të qëndrojë në solidaritet me studentët palestinezë në MIT, familjet e të cilëve mbeten në rrezik të madh dhe ekzistenca e të cilëve është një testament i *sumudit* apo qëndrueshmërisë palestineze. Ky pozicion duhet të plotësohet nga (3) një orientim publik larg partnerëve të korporatave bashkëpunëtore si Elbit, Maersk dhe Lockheed Martin, dhe veprim publik për të hequr fondet e Korporatës MIT nga firmat e implikuara në pushtimin e territoreve palestineze.

Për më tepër, MIT mundet dhe duhet ta vendosë ekspertizën shkencore dhe teknike të MIT në mbështetje të Palestinës dhe t'i zgjerojë mundësitë për studiuesit, studentët dhe institucionet shkencore palestineze, të ngjashme me Programin MIT-Ukrainë. Përpjekje të tilla mund të ndërtojnë programin Global MIT At-Risk Fellows for Palestine. Në planin afatgjatë, MIT duhet t'i rishikojë të gjitha bashkëpunimet me ushtrinë amerikane dhe Pentagonin, duke përfshirë Laboratorin Lincoln, për pajtueshmërinë me angazhimet e MIT ndaj ligjit ndërkombëtar humanitar. MIT duhet të ndërmarrë përpjekje me mirëbesim për të parandaluar që kërkimet e saj ta mbështesin qeverinë izraelite dhe t'i ndalojnë prodhuesit e armëve të rekrutojnë në kampus. Si një institucion me tokë të dhënë nga shteti, MIT duhet të punojë për të korrigjuar vjedhjen e tokave nga popujt indigjenë të kryer nga qeveria e SHBA. Dhe gjithashtu duhet të ndërmarrë hapa për ta transformuar arkitekturën e saj vendimmarrëse, veçanërisht Korporatën MIT të pazgjedhur dhe oligarkike, për të pasqyruar vlerat dhe interesat e shkencëtarëve të ndërgjegjes. Kjo ka qenë një kërkesë e kahershme e aktivistëve të MIT, që nga epoka kundër Luftës së Vietnamit deri në demokratizimin e MIT në vitet 2020.

5.1: Zyrtarët dhe Korporata e MIT

Për t'i bërë hapat më të qartë, më poshtë janë veprimet specifike që zyrtarët e MIT munden dhe duhet t'i ndërmarrin:

Presidentja e MIT Sally Kornbluth: Në bashkëpunim me rektorin, kancelarin dhe korporatën, Sally Kornbluth duhet të njoftojë menjëherë dhe publikisht një ndryshim në politikën e MIT se i pezullon për një kohë të pacaktuar kanalet e financimit të kërkimit dhe angazhimet institucionale me ministrinë izraelite të mbrojtjes dhe firmat e lidhura me të. Ajo duhet të shprehë solidaritetin me studentët palestinezë në MIT dhe të dënojë qeverinë izraelite për pushtimin e Gazës dhe krimin e aparteidit. Një udhëzues për një vendim të tillë do të ishte vendimi i Presidentit të MIT L. Rafael Reif në shkurt 2022, ku në konsultim me udhëheqjen e lartë, ai përcaktoi se duhet t'i jepej fund menjëherë marrëdhënies së MIT me Institutin e Shkencës dhe Teknologjisë Skolkovo (Skoltech).

Zyra e Presidentit duhet gjithashtu të shpallë financimin kalimtar për projektet kërkimore të prekura dhe të punojë me PI-të dhe punëtorët e diplomuar për të përfunduar punën e tyre kërkimore dhe akademike pa ndërprerje. Presidentja e MIT duhet gjithashtu të punojë me Grupin e Lartë të Rrezikut (Senior Risk Group) për t'i shtuar projekte të lidhura me Izraelin procesit të rishikimit të rrezikut të shtuar, të cilin aktualisht e kërkon për Kinën, Rusinë dhe Arabinë Saudite. Bazat për këtë përfshijnë shqetësimet e arsyeshme se: "rezultatet e kërkimit do të përdoren në mënyra që do të cenonin të drejtat politike, njerëzore ose civile në një vend të huaj" ose se angazhime të tilla: "do t'i legjitimojnë në mënyrë indirekte shkeljet e të drejtave politike, njerëzore ose civile në atë vend". Presidentja mund t'i mbështesë ata që preken me financim kalimtar dhe t'i korrigjojë ankesat e atyre që janë prekur nga vendimi i administratës së MIT për të arrestuar, ndaluar, dëbuar dhe frikësuar studentët e ndërgjegjes.

Rektorja e MIT Cynthia Barnhart: Në bashkëpunim me presidenten dhe korporatën, Cynthia Barnhart duhet të njoftojë menjëherë një ndryshim në politikën e MIT që i pezullon pafundësisht të gjitha kanalet e financimit të kërkimit dhe angazhimet institucionale me ministrinë izraelite të mbrojtjes. Një udhërrëfyes për një vendim të tillë do të ishte vendimi i Presidentit të MIT L. Rafael Reif në shkurt 2022, ku në konsultim me udhëheqjen e lartë, ai përcaktoi se duhet t'i jepej fund menjëherë marrëdhënies së MIT me Institutin e Shkencës dhe Teknologjisë Skolkovo (Skoltech). Rektorja mund të punojë gjithashtu për të pezulluar për një kohë të pacaktuar të gjitha angazhimet midis Elbit Systems dhe MIT. Një udhëzues do të ishte vendimi i vitit 2020 nga profesori i asociuar Richard K. Lester dhe Zëvendës Presidentja për Kërkimin Maria T. Zuber, në bashkëpunim me Grupin e Lartë të Rrezikut, për t'i dhënë fund pjesëmarrjes së Aramco-s saudite në Iniciativën e Energjisë së MIT dhe për të refuzuar çdo angazhim të mëtejshëm të sponsorizuar mes MIT dhe Aramco. Rektorja mund t'i mbështesë studentët e prekur të diplomuar në marrjen e fondeve kalimtare dhe t'i korrigjojë ankesat e sinqerta të atyre që janë prekur nga vendimi i administratorëve të MIT për të arrestuar, ndaluar, dëbuar dhe frikësuar studentët e ndërgjegjes.

Avokati i Përgjithshëm i MIT Mark C. DiVincenzo: Përveç mbështetjes së administratorëve të mësipërm në dënimin e krimeve izraelite në Gaza dhe dhënies fund lidhjeve kërkimore të MIT me ushtrinë izraelite dhe kompanitë bashkëpunëtore, Zyra e Avokatit të Përgjithshëm dhe shef ligjor i MIT Mark DiVincenzo duhet të edukoj**ë dhe mbësh**tesë MIT në përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj Konventës së Gjenocidit, e cila kriminalizon bashkëpunimin e një pale dytësore në gjenocid. Ai gjithashtu duhet ta **këshillojë MIT-in për detyrimet e tij ndaj parimeve të Konventave të Gjenevës, Statutit të Romës, Konventës së Aparteidit dhe ndalimeve federale për ofrimin e mbështetjes materiale për ushtritë abuzive dhe sponsorët shtetërorë të terrorizmit. Zyra e** avokatit **të përgjithshëm duhet të këshillojë më tej MIT-in që të jetë në përputhje me ligjin** e punës në SHBA, Aktin e të Drejtave Civile, Aktin e Arsimit të Lartë dhe Ligjin e të Drejtave, të cilat mbrojnë veprimin e bashkërenduar, fjalën e lirë dhe mosdiskriminimin në vendin e punës.

Së fundi, si anëtar i Komitetit Koordinues Ndërkombëtar (International Coordinating Committee) **të MIT dhe i Grupit të Lartë të Rrezikut,** avokati i përgjithshëm duhet ta mbështesë shtimin e të gjitha projekteve të sponsorizuara nga entitetet e lidhura me Izraelin në procesin e rishikimit të rrezikut të shtuar, gjë që kërkon aktualisht për Kinën, Rusinë dhe Arabinë Saudite. Kjo kërkohet nga shqetësimet e arsyeshme se: "rezultatet e kërkimit do të përdoren në mënyra që do të cenonin të drejtat politike, njerëzore ose civile në një vend të huaj" ose se angazhime të tilla: "do t'i legjitimojnë në mënyrë indirekte shkeljet e të drejtave politike, njerëzore ose civile në atë vend".

Kancelaria e MIT Melissa Nobles: Melissa Nobles duhet të veprojë sipas thirrjeve të saj t**ë mëparshme me shkrim për të** "shkolonizuar hulumtimin" dhe për "të krijuar një rrugë drejt drejtësisë së kthyeshme dhe pajtimit". Ajo mund ta bëjë këtë duke mbështetur menjëherë presidenten dhe korporatën në një ndryshim në politikën e MIT që pezullon pafundësisht të gjitha kanalet e financimit të kërkimit dhe angazhimet institucionale me ministrinë izraelite të mbrojtjes. Kancelaria gjithashtu mund të punojë me autoritetet e tjera të kampusit për të pezulluar pafundësisht të gjitha angazhimet midis Elbit Systems, Maersk, Lockheed Martin, Caterpillar dhe MIT. Kancelaria mund t'i mbështesë studentët e diplomuar të prekur në marrjen e fondeve kalimtare dhe t'i korrigjojë ankesat e sinqerta **të atyre që ndikohen nga vendimi i MIT për të arrestuar, ndaluar, dëbuar dhe frikësuar studentët e ndërgjegjes.**

Administratori i Besuar i Korporatës dhe arkëtar i MIT Glen Shor: Përveç mbështetjes së zyrtarëve **të mësipërm në dënimin e krimeve izraelite në Gaza dhe përfundimin e lidhjeve kërkimore të MIT me ushtrinë izraelite dhe kompanitë bashkëpunëtore, anëtarët e Korporatës MIT, duke përfshirë kryetarin Mark Gorenberg** dhe zyrtarin kryesor financiar **Glen Shor**, duhet të ndërmarrë hapa për të hequr 32 miliardë dollarë të zotërimeve financiare neto të MIT nga asetet e përfshira në pushtimin e territoreve palestineze.

Një udhëzues për një politikë të tillë mund të jetë vendimi i MIT në vitin 2007 për t'u larguar dhe për të dënuar gjenocidin e Darfurit në Sudan, si dhe vendimet e fundit nga Trinity College Dublin, fondet sovrane të pensioneve të Norvegjisë dhe fondi më i madh privat i pensioneve në Mbretërinë e Bashkuar, USS (Superannuation Universiteties Scheme) për t'u larguar nga asetet e implikuara në pushtimin ilegal, kolonial të territoreve palestineze. Administratorët e besuar individualë të korporatave në veçanti duhet të mbajnë dhe të agjitojnë për një votim për largimin. Për më tepër, korporata MIT mund të punojë për të transformuar veten në një organ vendimmarrës më demokratik dhe transparent, që përfaqëson zërin e studentëve dhe pedagogëve, jo të donatorëve dhe oligarkëve të pasur.

Nënrektori i MIT për Aktivitetet Ndërkombëtare Duane Boning: Si anëtar i Komitetit Koordinues Ndërkombëtar të MIT dhe i Grupit të Lart**ë të Rrezi**kut, nënrektori **për aktivitetet ndërkombëtare duhet të veprojë në koordinim me** zyrtarët e mësipërm për të njoftuar menjëherë një ndryshim në politikën e MIT që pezullon për një kohë të pacaktuar të gjithë kanalet e financimit të kërkimit dhe angazhimet institucionale me ministrinë izraelite të mbrojtjes. Nënrektori duhet të veprojë gjithashtu për t'i shtuar të gjitha projektet e financuara nga njerëz ose entitete nga Izraeli në procesin e rishikimit të rrezikut të lartë, të cilin aktualisht i kërkon për Kinën, Rusinë dhe Arabinë Saudite. Bazat **për një përfshirje të tillë janë të shumta, por përfshijnë shqetësime të arsyeshme se**: "rezultatet e kërkimit do të përdoren në mënyra që do të cenonin të drejtat politike, njerëzore ose civile në një vend të huaj" ose që angazhime të tilla: "do t'i legjitimojnë në mënyrë indirekte shkeljet politike, njerëzore, ose të drejtat civile në atë vend". Një udhëzues për një vendim të tillë do të ishte vendimi i paraardhësit të Duane Boning, Richard Lester, në bashkëpunim me Grupin e Lartë të Rrezikut **për t**'i dhënë fund pjesëmarrjes së Aramco-s saudite **në Iniciativën e Energjisë** të MIT dhe për të refuzuar çdo angazhim të mëtejshëm të sponsorizuar midis MIT dhe Aramco.

Nënpresidenti i MIT për Kërkimin Ian Waitz: Si anëtar i Komitetit Koordinues Ndërkombëtar të MIT dhe i Grupit të Lartë të Rrezikut, zyra e nënpresidentit për k**ërkime duhet të veprojë në koordinim me** zyrtar**ët e mësipërm për të pezulluar pafundësisht të gjitha kanalet e financimit të kërkimit dhe angazhimet institucionale me** ministrinë izraelite të mbrojtjes. Nënpresidenti Ian Waitz duhet gjithashtu të koordinojë për t'i shtuar të gjitha projektet e sponsorizuara nga entitetet e lidhura me Izraelin në procesin e rishikimit të rrezikut të lartë, të cilin aktualisht i kërkon Kinës, Rusisë dhe Arabisë Saudite. Bazat për këtë përfshirje janë të shumta, por përfshijnë shqetësime të arsyeshme se angazhime të tilla: "do të legjitimojnë në mënyrë indirekte shkeljet e të drejtave politike, njerëzore ose civile në atë vend". Një udhëzues për një vendim të tillë do **të ishte vendimi i paraardhëses së Ian Waitz, Maria Zuber në bash**këpunim me Grupin e Lartë të Rrezikut për t'i dhënë fund pjesëmarrjes së Aramco-s saudite **në Iniciativën e Energjisë MIT dhe për të refuzuar çdo angazhim të mëtejshëm të sponsorizuar midis MIT dhe Aramco. Nën**presidenti për kërkime duhet gjithashtu t'i shfrytëzoj**ë të gjitha mjetet** që ka në dispozicion **për të pezulluar pafundësisht të gjitha angazhimet e MIT me Elbit Systems, Maersk dhe Lockheed Martin.**

Zyra MIT e Aleancave Strategjike dhe Transferimit të Teknologjisë (Office of Strategic Alliances & Technology Transfer – OSATT): Si anëtar i Komitetit Koordinues Ndërkombëtar të MIT dhe Grupit të Lartë të Rrezikut, OSATT dhe drejtori ekzekutiv Gayathri Srinivasan duhet të veprojnë në koordinim me zyrtarët e mësipërm për t'i pezulluar pafundësisht të gjitha kanalet e financimit të kërkimit dhe angazhimet institucionale me ministrinë izraelite të mbrojtjes. OSATT duhet gjithashtu të veprojë për t'i shtuar të gjitha projektet e sponsorizuara nga entitetet e lidhura me Izraelin në procesin e rishikimit të rrezikut të shtuar, të cilin aktualisht i kërkon për Kinën, Rusinë dhe Arabin**ë Saudite.**

Kjo përfshirje garantohet nga shqetësimet e arsyeshme se: "rezultatet e kërkimit do të përdoren në mënyra që do të cenonin të drejtat politike, njerëzore ose civile në një vend të huaj" ose se angazhime të tilla: "do t'i legjitimonin **në mënyrë indirekte shkeljet e të drejtave politike, njerëzore ose civile në atë vend**". Një udhëzues për një vendim të tillë do të ishte vendimi i vitit 2020 për t'i dhënë fund pjesëmarrjes së Aramco-s saudite **në Iniciativën e Energjisë MIT dhe refuzimin e çdo angazhimi të mëtejshëm të sponsorizuar midis MIT dhe A**ramco. OSATT gjithashtu duhet t'i shfrytëzojë **të gjitha mjetet** në dispozicion **për të pezulluar pafundësisht të gjitha angazhimet e MIT me Elbit Systems, Maersk dhe Lockheed Martin.**

Këshillimi për Karrierë dhe Zhvillim Profesional i MIT (Career Advising & Professional Development – CAPD): MIT CAPD dhe drejtoresha ekzekutive **Deborah Liverman** duhet t'i shfrytëzojnë **të gjitha mjetet** në dispozicion **për t'**i ndaluar pafundësisht kompanitë e implikuara në pushtimin izraelit që të rekrutojnë studentë, studiues, staf dhe trup pedagogjik të MIT, në të gjithë panairet e karrierës. Kompani të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen në Lockheed Martin, Maersk, Elbit Systems dhe Caterpillar. Duke pasur parasysh shkallën sistematike të krimeve të kryera nga ushtria amerikane dhe kontraktuesit ushtarakë amerikanë dhe izraelitë, MIT CAPD ka një detyrim t'i dekurajojë studentët e MIT nga punësimi në kompleksin ushtarak-industrial. Në vend të kësaj, CAPD duhet të punojë me studentët për të kultivuar karriera që vlerësojnë dhe mëkëmbin jetën.

Programi i Ndërlidhjes Industriale së MIT (Industrial Liaison Program – ILP) dhe Marrëdhëniet Korporative: Drejtori i Marrëdhënieve Korporative të MIT-it **Gayathri Srinivasan** duhet t'i shfrytëzojë **të gjitha mjetet** që ka në dispozicion për t'i pezulluar menjëherë dhe pafundësisht Elbit Systems nga programi i ndërlidhjes industriale dhe shkëmbimi startup, duke pasur parasysh se Elbit është prodhuesi më i madh i armëve i Izraelit dhe se përfiton nga Gjenocidi i Gazës. Marrëdhëniet korporative duhet të ndërmarrin gjithashtu një rishikim të të gjitha 800+ firmave që marrin pjesë në shkëmbimin ILP dhe startup, duke përfshirë Boeing, Maersk, Microsoft, Google dhe të tjerë, për të shqyrtuar bashkëfajësinë e tyre në okupimin izraelit dhe shtetin kolonial. Një precedent për një vendim të tillë do të ishte vendimi i vitit 2020 nga MIT për t'i dhënë fund pjesëmarrjes së Aramco-s saudite **në Iniciativën e Energjisë** së MIT dhe për të refuzuar çdo angazhim të mëtejshëm të sponsorizuar midis MIT dhe Aramco pas vrasjes së gazetarit saudit Jamal Khashoggi. Duke pasur parasysh shkallën sistematike të krimeve të kryera nga ushtria amerikane dhe kontraktuesit ushtarakë amerikanë dhe izraelitë, Arsimimi Profesional i MIT ka një detyrim të dekurajojë kërkimin dhe ekspertizën e MIT në dobi të kompleksit ushtarak-industrial. Në vend të kësaj, Programi i Ndërlidhjes Industriale i MIT duhet të punojë me partnerë që vlerësojnë dhe mëkëmbin jetën.

Arsimi Profesional i MIT: Në bashkëpunim me zyrat e mësipërme, Drejtori Ekzekutiv i Arsimit Profesional i MIT, **Bhaskar Pant**, duhet t'i shfrytëzojë **të gjitha mjetet** në dispozicion për t'i ndaluar pafundësisht kompanitë bashkëpunëtore në pushtimin izraelit që të përfitojnë nga ose të rekrutojnë kërkime, njohuri dhe ekspertizë të MIT. Kompani të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në Elbit Systems, Lockheed Martin, Maersk dhe Caterpillar. Një precedent për një vendim të tillë do të ishte vendimi i vitit 2020 nga MIT për t'i dhënë fund pjesëmarrjes së Aramco-s saudite **në Iniciativën e Energjisë** së MIT dhe për të refuzuar çdo angazhim të mëtejshëm të sponsorizuar midis MIT dhe Aramco pas vrasjes së gazetarit saudit Jamal Khashoggi. Duke pasur parasysh shkallën sistematike të krimeve të kryera nga ushtria amerikane dhe kontraktuesit ushtarakë amerikanë dhe izraelitë, Arsimimi Profesional i MIT ka një detyrim të dekurajojë kërkimin dhe ekspertizën e MIT-it në dobi të kompleksit vrasës ushtarak-industrial. Në vend të kësaj, Arsimimi Profesional i MIT duhet të punojë me partnerë që e vlerësojnë dhe mëkëmbin jetën.

Qendra për Logjistikën e Transportit e MIT: Në bashkëpunim me zyrat e mësipërme, Qendra për Logjistikën e Transportit e MIT (Center for Transportation Logistics – CTL) dhe drejtori i saj **Yossi Sheffi** duhet të pezullojnë për një kohë të pacaktuar kontratën e saj aktuale me Maersk, duke qenë se Maersk po dërgon armë dhe komponentë armësh për përdorim nga forcat izraelite **për të kryer gjenocid në Gaza. Arsyeja për këtë përjashtim përfshin shqetësimet e arsyeshme se aktivitetet e korporatës Maersk:** "cenojnë të drejtat politike, njerëzore ose civile në një vend të huaj" dhe se angazhime të tilla të MIT: "do të legjitimojnë në mënyrë indirekte shkeljet e të drejtave politike, njerëzore ose civile në atë vend". Një precedent për një vendim të tillë do të ishte vendimi i vitit 2020 nga MIT për t'i dhënë fund pjesëmarrjes së Aramco-s saudite **në Iniciativën e Energjisë** së MIT dhe për të refuzuar çdo angazhim të mëtejshëm midis MIT dhe Aramco pas vrasjes së gazetarit saudit Jamal Khashoggi.

Iniciativat për Shkencë dhe Teknologji të MIT (Science and Technology Initiatives – MISTI): Në bashkëpunim me zyrat e mësipërme, Iniciativat për Shkencë dhe Teknologji të MIT (MISTI) duhet të ndërmarrin hapa për t'i pezulluar pafundësisht të gjitha fondet e tjera të farës së Lockheed Martin, duke përfshirë ato në Gjermani dhe Poloni, duke pasur parasysh që Lockheed Martin prodhon armë për përdorim nga forcat izraelite për të kryer gjenocid në Gaza. Drejtori Menaxhues i programeve MISTI në Rajonin e MENA-s, **David Dolev** duhet t'i rishikojë programet ekzistuese MISTI-Izrael për të përcaktuar nëse ato janë në përputhje me parimet antiaparteid dhe një proces rigoroz të rishikimit të rrezikut të lartë për të përcaktuar nëse këto angazhime do të ndihmojnë ose legjitimojnë në mënyrë indirekte "shkeljet e të drejtave politike, njerëzore apo civile në atë vend".

5.2: Trupi pedagogjik i MIT

Profesori i MIT Noam Chomsky në protestën e djegies së kartave të rekrutimit, 1967 © Peter Simon

> "Është përgjegjësi e intelektualëve të thonë të vërtetën dhe t'i demaskojnë gënjeshtrat".
>
> — Noam Chomsky, Profesor Emeritus i MIT, 1967

Përgjegjësinë për t'i dhënë fund gjenocidit në Palestinë e ndajnë trupi pedagogjik dhe hetuesit kryesorë (PI) të MIT. PI-të mund dhe duhet t'i refuzojnë menjëherë sponsorizimet dhe partneritetet me ushtrinë izraelite, Elbit, Maersk dhe korporata të tjera të implikuara në pushtimin izraelit. Komiteti Këshillimor Ndërkombëtar mund të këshillojë një ndalim të gjerë për sponsorët e kërkimit të qeverisë izraelite duke pasur parasysh shqetësimet reale të të drejtave të njeriut dhe të shtojë Izraelin në Procesin e Rishikimit të Rrezikut të Shtuar që kërkon aktualisht për Arabinë Saudite, Kinën dhe Rusinë. Këshilltarët e trupit pedagogjik kanë ndikim mbi studentët dhe mund të vendosin tonin se çfarë lloj bashkëpunimesh janë të pranueshme. Ata mund të pranojnë traumën dhe mizorinë që u shkaktohet palestinezëve dhe t'i inkurajojnë studentët që t'i drejtojnë talentet e tyre larg kompleksit ushtarak-industrial dhe drejt një morali shkencor të përgjegjshëm që promovon jetën dhe lulëzimin njerëzor. Trupi pedagogjik i interesuar gjithashtu mund të shkruajë, t'i përkulë mekanizmat ekzistues të qeverisjes së trupit pedagogjik dhe kanalet këshilluese, të miratojë rezoluta, të hyjë në grevë, t'u bashkohet studentëve në protestë, t'i mbrojë aktivistët studentorë në seancat disiplinore dhe të organizohet me Trupin pedagogjik dhe Stafin e MIT për Palestinën.

Trupi pedagogjik i MIT-it i kanë bërë ballë më parë militarizmit. Noam Chomsky dhe Henry Kendall sfiduan bashkëpunimin e MIT në militarizëm përmes forumeve si Greva e Shkencëtarëve për Paqen (Scientists Strike For Peace) dhe Buletini i Shkencëtarëve Atomikë (Buletin of the Atomic Scientists). Në vitet 1980, Willard R. Johnson u bë zëri kryesor në lëvizjen kundër aparteidit në Institut. Në vitin 1966, kryetari i departamentit të inxhinierisë mekanike të MIT-it Ascher Shapiro dhe kolegu i tij Ronald Probstein vendosën të zhvendosin agjendën kërkimore të Laboratorit të Mekanikës së Fluideve në teknologjinë civile. Shapiro la kërkimet balistike për të studiuar mekanikën e lëngjeve të valvulave të zemrës. Probstein hetoi mënyra për të çkripur më mirë ujin e detit. Të tjerët në laborator u morën me dizajnin e tymarëve, emetimet e oksidit nitrik dhe derdhjet e naftës. Deri në vitin 1969, dy të tretat e financimit të laboratorit vinin nga burime civile dhe gjysma e të diplomuarve po hynin në industrinë civile. Në vitin 1970, Shapiro kishte një vrull të mjaftueshëm për të kërkuar largim të plotë nga Pentagoni në të gjithë aparatin e financimit të MIT. Trupi pedagogjik duhet të ndërtojë mbi atë trashëgimi.

5.3: Studentët e MIT

> "Ata do të thonë se ne po trazojmë qetësinë. Nuk ka paqe. Ajo që i shqetëson ata është se ne po e trazojmë luftën".
>
> — Howard Zinn, 1971

Studentët e MIT-it kanë detyrimin të mësojnë për Palestinën, të edukojnë njëri-tjetrin, të kundërshtojnë, të protestojnë, të ndërpresin dhe në disa raste t'i k:erkojnë autoriteteve shpenzimet e sakta përmes veprimeve të drejtpërdrejta. Ky detyrim ndjek një traditë të drejtë të mosbindjes civile. Në vitin 1987, AAC-ja ngriti një lagje barakash në lëndinën Kresge për të nxitur Korporatën MIT të largohej nga Afrika e Jugut e aparteidit.

Në vitin 2007, aktivistët studentorë të MIT-it e shtynë me sukses MIT-in të dënonte dhe të largohej nga gjenocidi në Darfur, Sudan. Studentët e MIT-it u bashkohen paraardhësve tanë duke kërkuar që hulumtimi i MIT duhet të afirmojë jetën njerëzore, jo të ndërtojë të ardhme distopike dhe të militarizuara. Ne refuzojmë abuzimin e thirrjeve për lirinë akademike me qëllim që të fabrikohet pëlqimi për gjenocid. Siç tha kolegu ynë Ira Rubenzahl (udhëheqës studentor i SACC) për *The Tech* më 1969: "Askush nuk ka të drejtë të ndërtojë dhoma gazi për të vrarë njerëz". Kësaj ne i shtojmë: "Askush nuk ka të drejtë të ndërtojë dronë për të vrarë njerëz". Liria akademike duhet të ketë kufij; Institucionet shkencore dhe laboratorët nuk kanë të drejtë të bashkëpunojnë me kryesit e gjenocidit. Studentët e MIT mund t'i bashkohen Koalicionit për Palestinën të MIT.

Ne si shkencëtarë i bëjmë thirrje MIT-it që të ndalojë përdorimin e fuqisë sonë intelektuale për të zhvilluar armë dhe mjete për qeverinë izraelite në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar. Vetë Konventa e Gjenocidit e vitit 1951 kriminalizon bashkëpunimin e një pale dytësore në gjenocid. Duke ofruar mbështetje materiale dhe simbolike për ushtrinë izraelite, MIT po shkel Konventën e Gjenocidit. Ai po shkel gjithashtu Konventat e Gjenevës, Konventën e Aparteidit dhe ndalimet federale për ofrimin e mbështetjes materiale për ushtritë abuzive dhe sponsorët shtetërorë të terrorizmit. Qeveritë kombëtare dhe universitetet kanë dështuar në mënyrë të dukshme që të mbajnë përgjegjësi ndaj këtyre detyrimeve. Kështu, u takon studentëve të ndërgjegjes në lëvizjen kundër luftës, kundër aparteidit të rrisin kostot e luftës përmes kontestimeve popullore dhe akteve përçarëse të mosbindjes civile dhe sabotimit. Qëllimi i një fushate të tillë është i qartë: të kërcënojë ndjenjën e kontrollit të universitetit dhe të nxisë një krizë me shumë fronte – një krizë besimi, përfitimi, legjitimiteti, qeverisjeje dhe vullneti – e cila nuk mund të injorohet dhe që sipas fjalëve të Martin Luterit. King Jr. "do ta hapë në mënyrë të pashmangshme derën e negociatave". [85]

85 Martin Luther King Jr. "Letter from a Birmingham City Jail". 16 prill, 1963.

Seksioni 6: Përfundim

Seksioni 6:
Përfundim

Instituti i Teknologjisë në Massachusetts (Massachusetts Institute of Technology – MIT) ndihmon shtypësin në Palestinë përmes kërkimit të tij shkencor. MIT ka kryer kërkime mbi armët dhe mbikëqyrjen e sponsorizuar drejtpërdrejt nga Ministria e Mbrojtjes e Izraelit që nga viti 2008. Ky manual ka përshkruar se si veprimi izraelit në Palestinë është gjenocidal në qëllim dhe efekt dhe se nxitet nga një projekt kolonial i ardhacakëve. Me gjithë origjinën e tij antidemokratike dhe përcaktimin e tij antidemokratik, ky projekt gëzon mbështetje të madhe materiale nga qeveria amerikane si dhe nga aktorët privatë. Lëvizjet studentore të SHBA-ve kanë një rol në dëmtimin e mbështetjes amerikane për gjenocidin. Kjo mbështetje është imorale, e paligjshme dhe jopopullore brenda komunitetit të MIT. Në vitin 2024, supershumicat e studentëve ratifikuan dy referendume dhe një rezolutë të Këshillit të Studentëve të Diplomuar për t'i dhënë fund lidhjeve të MIT me krimet izraelite, me mbështetje të bollshme nga trupi pedagogjik dhe stafi. Politika e MIT kërkon që këto lidhje të marrin fund. MIT ka ndërmarrë veprime për të ndërprerë lidhjet me kërkimin shkencor dhe sponsorët e korporatave më parë për krimet kundër Ukrainës, Sinkiangut, Darfurit, disidentëve sauditë dhe të mbijetuarve të abuzimit seksual të fëmijëve.

Për më tepër, kërkesat e Koalicionit për Palestinën të MITqë nga vjeshta 2023 janë të arsyeshme, të qarta dhe të zbatueshme. Zyrtarët e lartë të MIT-it, duke përfshirë Presidentin, Rektorin, Nënrektorin, Kancelarin, Avokatin e Përgjithshëm dhe anëtarët e Korporatës kanë detyrime specifike, ashtu si trupi pedagogjik i MIT-it, PI-të, stafi dhe studentët. Çfarë është atëherë ajo që pengon? Pse ka papajtueshmëri? E vërteta është se MIT nuk është një institucion demokratik apo moral. Ai shtyhet nga forcat pro-izraelite në anën tjetër – donatorë të mëdhenj, alumni, administrues të besuar, ushtria amerikane dhe anëtarë reaksionarë të Kongresit. Pavarësisht se sa bindshëm koalicioni i bën thirrje ndërgjegjes së udhëheqjes së institucionit, sado të forta qofshin argumentet tona, institucioni do të lëvizë vetëm në një çështje të polarizuar siç është Palestina, kur kostot e përpjekjes t'i tejkalojnë kostot e ndryshimit. Për këtë arsye, studentët e MIT duhet të përcaktojnë një kosto, të cilën nuk mund ta bëjnë manualët e kërkimit dhe e-mailet e sjellshme. Aktualisht, kjo mund të duket e vështirë ndërsa shteti i aparteidit duket i pathyeshëm: Izraeli po djeg Gazën përtokë dhe po lufton në fronte të shumta. Ai sundon mbi miliona njerëz pa të drejta themelore të njeriut dhe gëzon bekimin e paracaktuar të partive kryesore politike amerikane, zyrtarëve të universitetit, ushtrisë dhe korporatave të mëdha.

